

2016

Aktiviteti Institucional i FSHZH-së

# RAPORT VJETOR

Programet e Investimeve

Realizimi Financiar

Projekte te reja

Auditi i Brendshëm

Monitorimi & Vlerësimi

Ndërtimi i Kapaciteteve

Komunikimi & Informimi



**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**  
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

**SHKURTIME**

AB	Auditi i Brendshëm
BB	Banka Botërore
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BEI	Banka Europiane e Investimeve
CEB	Banka e Këshillit të Europës
DPUK	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës Kanalizimeve
DZHR	Departamenti i Zhvillimit Rajonal
FIDIC	Federata Ndërkombëtare e Konsulencës Inxhinierike (International Federation of Consulting Engineers)
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
FUZR	Furnizimi me Ujë e Zonave Rurale
FZHR	Fondi për Zhvillimin e Rajoneve
GoA	Qeveria Shqiptare
IDA	Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim
IDB	Banka Islamike e Investimeve
IPA	Instrumenti i Ndihmës së Paraaderimit Assistance
KD	Komiteti Drejtues
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KZHR	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve
MIS	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit
NTA	Norway Trust Account
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OFID	Fondi i OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar
SIF	Fondi i Investimeve Sociale
ToR	Terma Reference
WBIF	Kuadri i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (Western Balkans Investment Framework)

**Pasqyra e lëndës**

1.	PËRMBLEDHJE .....	4
2.	Bashkëpunimi i FSHZH me Fondin e Zhvillimit të Rajoneve në kuadër të Projekteve të Infrastrukturës Vendore .....	8
3.	Programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore e Lokale në Shqipëri” .....	10
4.	Programet e Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale .....	15
4.1	“Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”, SIF IV .....	15
4.2	“Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III” .....	16
5.	Programi Punët në Komunitet IV “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonës Bregdetare” .....	18
6.	Rikonstruksioni i rrugës së Lumit të Vlorës .....	20
7.	Projekti për Zhvillim të Integruar Urban dhe Turistik (PZHIUT) .....	20
8.	Programet e CBC/IPA (HERA), financuar nga BE dhe FSHZH .....	22
8.1	Vija bregdetare e qytetit të Vlorës - Lungomare .....	22
8.2	Projekti HERA .....	22
8.3	IPA 2012 – Përmirësimi i aksesit në shërbimet publike për grupet vulnerable në zonat periferike në qytetet Tiranë dhe Durrës .....	23
9.	AKTIVITETI INSTITUCIONAL .....	24
9.1	Menaxhimi Financiar .....	24
9.2	Komunikimi dhe Informimi .....	30
9.3	Monitorimi dhe Vlerësimi .....	31
9.4	Auditimi i brendshëm .....	32
9.5	Misione të donatorëve .....	34
10.	AKTIVITETE TE TJERA .....	35
10.1	Përgatitja dhe aplikimi për projekte të reja .....	35
10.2	Bashkëpunimi rajonal .....	35

## 1. PËRMBLEDHJE

Fondi Shqiptar i Zhvillimit gjatë vitit 2016 është angazhuar intensivisht në përmbushjen e misionit të tij për nxitjen e një zhvillimi ekonomik dhe social të qëndrueshëm, në nivel rajonal dhe lokal për të arritur sa më mirë objektivat e Qeverisë Shqiptare për një zhvillim të integruar e harmonik të vendit.

Gjatë vitit 2016 puna e FSHZH është fokusuar në dy drejtime kryesore, zbatimin dhe përmbylljen e projekteve aktuale dhe përgatitjen e projekteve të reja për financim.

### Projekte aktuale

Burimet kryesore të financimit të projekteve të zbatuara nga FSHZH gjatë vitit 2016, janë Qeveria Shqiptare, institucione financiare dhe banka zhvillimore si EBRD, EIB, Bashkimi Europian, KfW, IDB, CEB, etj.

Gjatë vitit 2016, investimet e kryera në kuadër të **Fondit për Zhvillimin e Rajoneve**, zënë peshën më të madhe të investimeve të kryera nga FSHZH me 51 % të buxhetit të akorduar. Këte vit kanë qënë në proces zbatimi 19 objekte infrastrukturore. Ecuria e investimeve fizike ka qënë e kënaqshme dhe parashikohet që gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017 të përfundojnë punimet civile për pjesën më të madhe të projekteve.

Viti 2016 mund të konsiderohet viti i mbylljes së investimeve të Programit **“Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”**. Gjatë këtij viti FSHZH ka ndjekur zbatimin dhe periudhën e garancisë për 37 segmente rrugore dhe ura, me një realizim financiar prej rreth 14.36 milionë Euro.

Vëmendje dhe angazhim të veçantë ka pasur projekti i **Shëtitorës Bregdetare në Vlorë** si një projekt kompleks i zhvillimit urban në vend. Ndërkohë që FSHZH ka përfunduar me financimin e zbatimit të komponentëve financiar nga Qeveria Shqiptare, si mbushja me rërë e plazhit dhe gjelbërimi, po ndiqet në mënyrë të përditshme ecuria e projektit në komponentët e tjerë si rikonstruksioni i rrugës, ndërtimi i shëtitorës, shesheve publike dhe elementëve të arredimit urban. Punimet për këto komponentë janë kryer në masën 76 %.

**Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”**, “SIF IV” ka financuar 15 skema ujësjellësash të cilët kanë përfunduar punimet civile dhe tashmë janë në periudhë garancie.

**Projekti “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”**, parashikon ndërhyrje në shkallë të gjërë në të gjithë vendin. Në këtë kuadër gjatë këtij viti është ngritur një skemë e tërë aplikimesh nga të gjitha bashkitë e vendit dhe aktualisht po kryhet në terren hartimi i fizibiliteteve teknike dhe sociale për rreth 30 skema prioritare. Gjatë vitit 2017 do të fillojë puna për hartimin e projekteve teknike dhe punimet civile, të cilat do të jenë të organizuara në Lot-e.

Punë intensive është zhvilluar edhe për zbatimin e programit **për Zhvillimin e Alpeve Shqiptare dhe zonës bregdetare të vendit**, i cili mbështetet financiarisht nga CEB dhe Qeveria Shqiptare. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti gjatë këtij viti ka pasur një punë intensive për hartimin e rreth 9 paketave të projektive në projektet urbane në Vlorë dhe Himarë. Muaji shtator 2016 shënoi dhe fillimin e zbatimit të punimeve civile, ndërsa disa projekte janë në fazë tenderimi. Nga ana tjetër vijon puna e Konsulentit Ndërkombëtar për hartimin e masterplanit të Alpeve që do të jetë baza për identifikimin e ndërhyrjeve prioritare.

## Projekte të reja

Në kuadër të projektit për rikonstruksionin e **rrugës së Lumit të Vlorës**, në 30 mars 2016 u nënshkrua Marrëveshja e Kredisë nga Fondi Kuvajtian dhe Ministria e Financave. Gjatë kësaj kohe është punuar për rishikimin e projektit teknik si dhe tenderimin e punimeve dhe supervizionit. Parashikohet që në shkurt 2017 të lidhet kontrata për fillimin e punimeve civile. Në këtë kuadër parashikohet që edhe Fondi Saudit për Zhvillim të financojë rreth 30 milionë USD që do të përdoren për financimin e pjesës e dytë të rrugës së Lumit të Vlorës, duke plotësuar kështu të gjithë financimin e nevojshëm për ndërtimin e rrugës. Në muajin shtator përfaqësues të Fondit Saudit për Zhvillim vizituan Shqipërinë dhe nënshkruan marrëveshjen e financimit.

Në shtator 2016 është firmosur marrëveshja e financimit të **Projektit për Zhvillim të Integruar Urban dhe Turistik**, i cili do të financohet nga Banka Botërore në vlerën 63.8 milionë Euro. Projekti parashikohet të fillojë në vitin 2017 dhe do të ketë një kohëzgjatje 5 vjeçare. Ai shtrihet në qendrat urbane të Sarandës, Gjirokastrës, Beratit, Përmetit dhe përgjatë korridorit turistik që kalon në këtë rajon. Gjatë kësaj periudhe një ekip i FSHZH ka punuar intensivisht me ekipin e Bankës Botërore dhe MZHU për përgatitjen e gjithë dokumentacionit të nevojshëm (Dokumenti i Vlerësimit të Projektit, Plani i Prokurimeve, Dokumenti Kuadër për politikat Mjedisore e të Shpronësimeve, Manuali Operacional i projektit etj.) për aprovimin e projektit në Bordin e Bankës Botërore dhe në Qeverinë Shqiptare. Një sërë punësh përgatitore janë kryer për lehtësimin e fillimit të menjëhershëm të zbatimit të projekteve me miratimin e kredisë.

Një tjetër angazhim i FSHZH gjatë këtij viti ka qenë përgatitja e një paketë per segmentet rrugore prioritare të cilat do financohen nga Qeveria Shqiptare.

## Aktivitete të tjera

Gjatë kësaj periudhë në bashkëpunim me Bashkitë përfituese, FSHZH ka ndjekur përgatitjen e një sërë projektesh të rëndësishme të rikualifikimit urban në shumë bashki të vendit, Kjo skemë e financuar nga Qeveria Shqiptare dhe bashkëfinancuar nga Bashkitë ka qenë shumë e sukseshme për përgatitjen e projekteve cilësore të financuara në vijim nga FZHR.

Progres është shënuar edhe përsa i përket projekteve, të financuara nga fondet e Instrumentit të Paraaderimit (IPA), qoftë të zbatimit të projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar apo aplikimeve të reja në këtë skemë. Janë ndjekur me vëmendje për zbatimin dhe disbursimin e TVSH-së edhe projektet e menaxhuar nga Delegacioni i BE-së ku FSHZH është organizatë përfituese.

Është përgatitur me kërkesë të Qeverisë Shqiptare një studim për akset kryesore të rajoneve të ndryshme të vendit sa i përket priorizimit, kostove e gatishmërisë për financim si projekte që mund të financohen nga Qeveria apo donatorë të tjerë.

Një tjetër angazhim i FSHZH-së gjatë kësaj periudhe ka qenë edhe kontributi në bashkëpunimin strategjik mes Shqipërisë dhe Kosovës. Për këtë arsye që nga fillim viti Fondi Shqiptar i Zhvillimit u përfshi në përpjekje për rivitalizimin e angazhimit për bashkëpunim të ngushtë institucional, ekonomik e kulturor mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Gjatë vitit 2016, buxheti i rishikuar është realizuar në masën 82% ose rreth 38 milionë Euro. Investimet gjatë kësaj periudhe janë realizuar në masën 33.2 mln Euro apo rreth 89% e buxhetit.

Në përgjithësi ka pasur ecuri të mirë të projektet në proces zbatimi, të cilat kanë nivel të kënaqshëm të realizimit të investimeve.

Ndërkohe ka pasur vonesa në miratimin e procedurave të pagesave dhe tenderimit nga Donatorët në fillim të projekteve të reja veçanërisht për Fondin Kuvajtian dhe CEB, ndërkohë që ka patur vështirësi sidomos në realizimin e kontratave me institucione të treta.

Gjatë këtij viti, ka vijuar informimi publik përmes mediave vizive dhe atyre të shkruara, nëpërmjet së cilës është siguruar dhe njohja e gjerë e publikut me rezultatet e punës së FSHZH-së si dhe aktivitetet në vijim.

Vlen për t'u theksuar se gjatë këtij viti ka vijuar bashkëpunimi intensiv dhe i suksesshëm me ministritë e linjës dhe agjencitë shtetërore.

## Paraqitja e nënprojekteve sipas donatorëve dhe statusit të tyre Dhjetor 2016

Donatori	Totali	Projekte në fazën e përgatitjes së dokumentacionit	Në tenderim / vlerësim	Në kontraktim	Në zbatim	Projekte të përfunduara Në Garanci
Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III	30	30				
KfW (SIF IV) Komponenti Ujësjetës	16					16
OFID I & II (SLRP)	4					4
IDB – ISTISNA (SLRP)	5					5
EBRD, EIB & IPA 2010-2011(SLRP)	21					21
IPA 2013 (Lungomare)	1				1	
KfW & IPA 2009 (SLRP)	7					7
Qeveria Shqiptare 2014 – 2015 (FZHR)	64				10	54
GoA investime 2016	3				2	1
Projekti i Puneve ne Komunitet CEB IV	10	6	3		1	
Fondi Kuvaitian	1		1			
<b>TOTALI</b>	<b>162</b>	<b>36</b>	<b>4</b>		<b>14</b>	<b>108</b>

## **2. Bashkëpunimi i FSHZH me Fondin e Zhvillimit të Rajoneve në kuadër të Projekteve të Infrastrukturës Vendore**

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve ka shënuar një transformim të rëndësishëm, nga një instrument financimi i projekteve të vogla me impakt të kufizuar, drejt financimit të projekteve më të mëdha me ndikim rajonal, në funksion të vizionit të transformimeve urbane të qendrave të qyteteve të mëdha.

Duke vlerësuar kapacitetet dhe performancën e lartë të FSHZH-së, për periudhën 2014 - 2016, Qeveria Shqiptare i ka akorduar zbatimin e 64 objekteve të ndryshme infrastrukturore dhe 6 projekte studimore me një vlerë totale prej rreth 8.18 miliardë Lekë.

### **2.1.1 Zbatimi i projekteve të akorduara nga FZHR për periudhën 2014 - 2016**

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është një nga përfituesit më të mëdhenj të fondeve të akorduara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve. Gjatë periudhës 2014-2016, janë miratuar 64 objekte të ndryshme infrastrukturore dhe 6 projekte studimore me një vlerë totale prej rreth 8.18 miliardë Lekë, të cilat zbatohen nga FSHZH. Këto financime janë fokusuar në disa drejtime prioritare:

- (i) 39 Projekte për përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe asaj urbane, (Hyrjet e Tiranës nga Durrësi dhe Elbasani, Sistemimi i 2 shesheve në Tiranë, Unaza e Divjakës, Rruga Transballkanike në Vlorë, Mbushja me rërë e plazhit Vlorë, rruga e Dajtit, Sheshi i Kukësit, Shëtitorja Himarë, etj);
- (ii) 5 Projekte të furnizimit me ujë (ujësjellësat në Sarandë, Dhërmi, Ksamil);
- (iii) 10 Projekte mjedisore dhe gjelbërimi (Pyllëzimi i Krastës në Krujë, Gjelbërimi i aksit rrugor Plepa – Vlorë, Gjelbërimi i vijës bregdetare të Vlorës dhe Parkut të Liqenit Artificial në Tiranë; Gjelbërimi i aksit Levan – Kakavijë, Lushnje - Berat, Gjelbërimi i aksit IKV- Surrel, dhe Segmentit Lin – Pogradec, etj.);
- (iv) 4 Projekte arsimore që synojnë rikonstruksionin e disa shkollave, Shkolla e mesme e bashkuar Tunjë, Gramsh; Shkolla 9 vjeçare në fshatin Sheq të Frakullës, Shkolla 9 vjeçare në Toshkëz, komuna Allkaj; Shkolla 9-vjeçare Dërsnik, komuna Voskop.
- (v) 6 Projekte studimore, trashëgimi kulturore dhe të dhëna gjeohapësinore (përgatitja e projektit teknik për Lungomaren, Restaurimi dhe Muzealizimi i Fototekës Marubi, projekti i krijimit të të dhënave gjeohapësinore për mbështetjen e zhvillimit rajonal, përgatitjes së projekteve për vitin 2015-2016, Hartimin e studimeve dhe projekt-ideve për projektet urbane, ku përfshihen realizimi i masterplanit të Qytetit Studenti, masterplani i Parkut të Liqenit Artificial, projekt-idea për Ishullin e Osumit, supervizioni estetik i Lungomares, etj.



**Projektet e infrastrukturës rrugore.** Kanë përfunduar punimet në 37 objekte; në fazën e zbatimit të punimeve janë 2 objekte. Punimet në të gjitha objektet parashikohen të përfundojnë në Maj 2017.

**Projektet e furnizimit me ujë në zonën e Bregdetit të Jugut.** Punimet kanë përfunduar në të gjitha skemat e ujësjellësave. Pjesa më e madhe e këtyre ujësjellësave u është dorëzuar bashkive përfituese.

**Projektet mjedisore.** Punimet e mbjelljes së pemeve kanë përfunduar në 8 objekte, nga te cilat 2 janë mbyllur përfundimit dhe 6 të tjera janë në periudhë mirëmbajtje. Në dy objekte të tjera punimet janë në proces dhe pritet të mbyllën gjatë vitit 2017.

**Projektet e rikonstruksionit të shkollave.** Punimet kanë përfunduar në të gjitha shkollat. Objektet ndodhen në periudhën e garancisë së defekteve dhe pritet t'i dorëzohen bashkive përfituese gjatë vitit 2017.

**Projektet studimore, hapësinore, të trashëgimisë kulturore, etj.** Në kuadër të këtyre projekteve vlen të përmendet angazhimi i FSHZH-së në përgatitjen e disa projekteve të rëndësishme si përgatitja e projektit teknik të fazës së dytë të Lungomares, përgatitja e një projekti bashkëkohor për restaurimin dhe muzealizimin e Fototekës Marubi, krijimin e sistemit të të dhënave gjeohapësinore për mbështetjen e zhvillimit dhe menaxhimit rajonal, hartimin e projekteve për zonën Tiranë – Durrës dhe Bregdetin e Jugut, përgatitja e projekteve të zhvillimit të zonave urbane, si dhe përgatitja e disa Master Planeve si ai i qytetit Studenti, i Parkut Sportiv në Korçë, i Parkut të Liqenit Artificial, projekti i rikonstruksionit e ndryshimit të destinacionit të ish-laboratorit hidraulik në Qendër Arti, etj.

### **2.1.2 Studime, Projekttime dhe Mbikqyrje për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve 2016**

Gjatë vitit 2015, Qeveria Shqiptare nëpërmjet Fondit të Zhvillimit të Rajoneve miratoi një fond i cili ë bashkëfinancon përgatitjen dhe hartimin e projekteve teknike për infrastrukturën vendore për periudhën 2016 - 2017. Qëllimi i këtij fondi është përgatitja në kohë dhe me cilësi e projekteve teknike të gatshme për financim nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.

Në këtë kuadër studio projektimi, (që do të kenë në stafin e tyre arkitektë me eksperiencë ndërkombëtare), janë angazhuar për hartimin sipas nevojës së projekt-ideve apo projekteve të plota të zbatimit për zhvillimin e territorit të bashkive përkatëse.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit ftoi 12 bashkitë qendër qarku për të marrë pjesë në procesin e prokurimit për perzgjedhjen e 6 bashkive.

Nga ky proces janë përzgjedhur Bashkitë Tirane, Durrës, Vlorë, Korçë, Shkodër dhe Berat. Gjatë këtij viti janë ndjekur procedurat për përgatitjen e ToR-eve për përzgjedhjen e studiove të projektimit të cilat janë duke hartuar dhe do të hartojnë projektet e plota teknike për përmirësimin e infrastrukturës vendore në 6 bashkitë e përzgjedhura.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2015, janë kontrolluar dhe ripunuar një seri projektesh teknike, përfshirë këtu edhe projektet e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve.

Për të gjitha projektet janë plotësuar dosjet me projektin, preventivin dhe gjithë dokumentacionin përkatës.


### 3. Programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore e Lokale në Shqipëri”

Programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, bashkëfinancuar nga Banka Botërore, Qeveria Shqiptare dhe Donatorë të tjerë në vlerën 368 milionë USD, synon të rrisë përpjekjet konkrete për përmirësimin e infrastrukturës në vend si dhe për rritjen e aksesit ndaj shërbimeve bazë dhe tregjeve, veçanërisht në zonat rurale nëpërmjet rehabilitimit të rrjetit rrugor dytësor dhe lokal.

Programi, deri në Dhjetor 2016, është financuar në shumën rreth 368 milionë USD dhe ka avancuar në të gjithë komponentët e tij.

Donatori	Financimi (milionë)
<sup>1</sup> BB	20 USD
OFID (OPEC) I & II	25 USD
GoA	9 USD
CEB	40 EUR
NTA	0.18 EUR
IPA 2008	8 EUR
BERZH	50 EUR
BEI	50 EUR
IDB/ ISTISNA	40 USD
KfW	15 EUR
IPA 2009	8.8 EUR
IPA 2010	20 EUR
IPA 2011	14.5 EUR
WBIF	4 EUR
DEVOLL HYDRO POWER	0.76 EUR
<sup>2</sup> Total (milionë USD)	<b>367.62 USD</b>

Punimet kanë përfunduar në gjitha segmentet rrugore dhe dhjetori i këtij viti mund të konsiderohet si muaji që përmbylli me sukses investimet në terren për një nga programet më ambicioze të zbatuara në këto 25 vitet e fundit në Shqipëri. Që nga fillimi i zbatimit të PRRDL-së deri më 31 Dhjetor 2016, FSHZH ka financuar rikonstruksionin e 144 segmenteve rrugore dytësore & lokale dhe urave, me një gjatësi totale prej rreth 1177 km. Gjatë vitit 2016 në kuadër të implementimit të këtij programi, FSHZH ka ndjekur zbatimin e 7 segmenteve rrugore në një gjatësi prej 66.5 km dhe periudhën e garancisë për 30 segmente rrugore.



1 Në marrëveshje financimi është 12.2 milionë SDR

2 Kursi mesatar i këmbimit për periudhën 2008 – 2015 Eur/USD = 1.30

## **Ecuria e deritanishme e projektit**

### **Komponenti i parë:** Financimi i aktiviteteve mbështetëse të programit:

Financimi i aktiviteteve mbështetëse të Programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale” është komponenti i parë i cili në thelb të tij ka një sërë procesesh kyçe dhe mjaft të rëndësishme për mbarrëvajtjen e programit. Inventarizimi i rrjetit rrugor dytësor dhe lokal, hartimi i projekteve teknike, zbatimi i procedurave transparente të prokurimit, supervizimi dhe konsulenca e specializuar ndërkombëtare, aplikimi i procedurave mjedisore gjatë zbatimit të punimeve, funksionim-mirëmbajtja dhe ngritja e kapaciteteve kanë qenë disa nga proceset kyçe që kanë kontribuar në zbatimin me sukses të këtij programi.

### **Inventarizimi rrjetit rrugor dytësor dhe lokal**

Ky komponent përfshin përgatitjen e bazës së të dhënave për rrugët rurale si dhe përgatitjen e dokumentacionit të prokurimeve për fazën e implementimit. Nga një total prej 9800 km rrugë dytësore dhe lokale, ka përfunduar inventarizimi i plotë me të dhëna të detajuara për rreth 4247 km, të identifikuar si rrugë kryesore të rrjetit rrugor rural. Për çdo segment rrugor, i cili është pjesë e këtij inventari, janë mbledhur të dhëna të hollësishme, si popullsia, trafiku, gjendja (ashpërsia e rrugës), aksesit që krijon si edhe varfëria në zonë. Është bërë një analizë shumëkriterëshe për secilin nga këto seksione, e përbërë nga disa komponentë. Paralelisht me zhvillimin e këtij procesi, vijon puna për përditësimin e të dhënave ekzistuese në inventar, duke i rifreskuar me të dhënat aktuale të rrugëve të rikonstruara, ose në proces rehabilitimi. Në fund të muajit Dhjetor 2016 rezultoi se kjo analizë është kryer për rreth 662 km rrugë.

### **Hartimi i projekteve teknike**

Përsa i përket hartimit të projekteve teknike, që financohen në kuadër të këtij programi, janë projektuar mbi 1200 km rrugë. Për këtë proces janë kontraktuar disa kompani, të cilat kanë përgatitur dhe dorëzuar projektet teknike, përgatitjen e dokumentave të prokurimit. Për të gjitha projektet janë plotësuar dosjet me projektin, preventivin dhe gjithë dokumentacionin përkatës. Një pjesë e segmenteve rrugore kanë pasur projekte teknike të hartuara nga NJQV-të përkatëse. Këto projekte janë kontrolluar dhe rishikuar nga Njësia e Mbështetjes Teknike pranë FSHZH-së dhe janë dërguar për ripunim në rastet kur ka qenë e nevojshme. Paralelisht me kontrollin e projekteve teknike kryhet edhe hedhja e gjurmës së rrugëve në Google Earth.

### **Prokurimi**

Procedurat e prokurimit për punimet civile në këtë program janë kryer në përputhje me Udhëzuesit e Bankës Botërore “Guidelines: Procurement Under IBRD Loans and IDA Credits Procurement”. Rrugët e financuara nga BERZH dhe BEI janë prokuruar në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në Marrëveshjen e Financimit të Projektit për Rrugët Dytësore dhe Lokale dhe Udhëzuesit e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, publikuar në Janar të 1992 dhe rishikuar në Maj të 2010. Rrugët e financuara nga Banka Botërore, GoA, OFID, dhe CEB, janë tenderuar sipas metodës “tender i hapur ndërkombëtar”. Ndërkohë, prokurimi i punimeve civile për rrugët e financuara nga IDB po kryhet sipas metodës “tender i hapur kombëtar”. Rrugët e financuara nga KfW dhe IPA 2009 janë tenderuar sipas metodës “tender i hapur ndërkombëtar”.

### **Supervizimi i kontratave të punimeve civile**

Supervizimi i kontratave të punimeve civile të rrugëve dytësore dhe lokale kryhet nga kompania JV IRD & Eptisia e cila kryen shërbimet e konsulencës së supervizionit për një periudhë katërvjeçare, deri në fund të vitit 2016.

### **Procedurat mjedisore**

Në kuadrin e Programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, një vëmendje e veçantë i është kushtuar ndjekjes së procedurave mjedisore siç parashikohen në Manualin e Procedurave, në kërkesat e programit dhe marrëveshjet me donatorët. Është ndjekur procesi i marrjes së lejes së mjedisit, që nga përgatitja e dokumentacionit përkatës, organizimi i konsultimit me publikun dhe aplikimi për leje për të gjitha rrugët e reja në kuadër të këtij programi. Njëkohësisht është kontrolluar zbatimi i Planit të Menaxhimit të Mjedisit dhe në rast mosplotësimi të kriterëve të vendosura, janë aplikuar penaltitetet përkatëse.

### **Funksionim – Mirëmbajtja dhe Ngritja e Kapaciteteve**

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve për funksionim mirëmbajtjen e rrugëve, FSHZH është duke realizuar Programin “Mbështetja e Zhvillimit të një Sistemi të Qëndrueshëm të Mirëmbajtjes së Rrugëve në Qeverisjen Lokale” financuar nga BEI (Banka Europiane e Investimeve), i cili filloi zbatimin në fillim të vitit 2014 (shkurt) dhe përfundon në vitin 2016. Roughton International Ltd (RI) është kontraktuar për ofrimin e shërbimeve të konsulencës. Problemi kryesor që adreson programi lidhet me mirëmbajtjen e pamjaftueshme të rrjetit rrugor në vendin tonë. Programi synon të arrijë ndërtimin e kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese në mirëmbajtjen e rrugëve në nivelin lokal. Target i programit, veç njërive vendore, janë edhe politikanët, kontraktorët, stafi i FSHZH si dhe aktorë të tjerë lokal. Produktet e prodhuara nga konsulenca janë:

- Discussion Paper – fokusi i këtij produkti është çështja e mirëmbajtjes së rrugëve në kuadër të Programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale. Gjetjet e rezultuara nga rishikimi i kontratave të punimeve të PRDL dhe rekomandimet e gjeneruara do të sigurojnë që rrugët e rikonstruara do të mirëmbahen si duhet në të ardhmen.
- Policy paper - Dokumenti i Politikave Rrugët Rajonale dhe Lokale: Mbështetje për Zhvillimin e Sistemit të Qëndrueshëm të Mirëmbajtjes së Rrugëve. Dokumenti i Politikave parashtron një analizë kritike të situatës aktuale në lidhje me çështjen e mirëmbajtjes së rrugëve lokale, implikimeve të reformës administrative-territoriale në këtë çështje si dhe eksplorimit të mënyra të ndryshme për t'u zbatuar në mirëmbajtjen e rrugëve. Gjithashtu, gjenerimi i një serie rekomandimesh për politikëbërësit me qëllim sigurimin e një sistemi efektiv për mirëmbajtjen e rrugëve përbën një nga qëllimet e Dokumentit.

Në vijim konsulenca u fokusua në produkte të tjera të cilat lidhen më shumë me plane veprimi për FSHZH dhe aktorë të tjerë për krijimin dhe zbatimin e një sistemi efektiv të mirëmbajtjes së rrugëve.

FSHZH ka kryer transferimin e 57 rrugëve pranë ARRSH, së bashku me rrugët dhe programin ROMAPS të planifikimit e mirëmbajtjes së rrugëve Në të përfshihet informacioni për të gjitha rrugët e marra në dorëzim nga ARRSH. Pranë ARRSH-së, pas përfundimit do të kalojnë edhe rrugët që janë duke u rindërtuar. Dorëzimi i rrugëve të përfunduara është shoqëruar edhe me Sistemin e Menaxhimit të Aseteve të Rrugëve Dytësore dhe Lokale, sistem i cili lejon ARRSH-në të kryejë planifikimin dhe buxhetimin e mirëmbajtjes së tyre. Ndërkohë, pranë NJQV-ve janë dorëzuar 50 segmente rrugore lokale. Që nga fillimi i zbatimit të programit, janë kryer dy cikle trajnimesh për NJQV-të në të gjithë vendin, lidhur me funksionim dhe mirëmbajtjen e rrugëve të rikonstruara në kuadër të PRRDL.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të Njësive të Qeverisjes Vendore lidhur me mirëmbajtjen e sistemit rrugor dytësor dhe lokal, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me financim nga Banka Europiane e Investimeve ka ndërmarrë një program të gjërë trajnimesh në 61 bashkite e reja të vendit.

Me fokus **Mbështetjen për Zhvillimin e Sistemit të Qëndrueshëm të Mirëmbajtjes së Rrugëve në Qeverisjen Lokale**, përmes këtij programi është siguruar trajnimi i rreth 200 specialisteve, staf i menaxhimit teknik në 61 bashkitë dhe partnerët e tjerë relevantë, me orientime të nevojshme për menaxhimin efektiv të punëve të mirëmbajtjes së rrugëve. Në këtë kuadër FSHZH ka vënë në dispozicion të aktorëve të përfshirë në procesin e mirëmbajtjes një soft për llogaritjen e buxhetit të mirëmbajtjes së rrjetit rrugor dytësor dhe lokal të bashkive.

Ky program trajnimesh ka filluar në Nëntor 2016 dhe do të vijojë deri në Shkurt të vitit 2017.

**Komponenti i dytë** – Financimi i punimeve civile për përmirësimin e rrugëve prioritare rajonale dhe lokale.

### **Rrugët e financuara nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Banka Europiane e Investimeve (EIB), IPA 2010 - 2011**

EBRD, EIB, IPA 2010-2011 kanë financuar këtë program me 138.5 milionë Euro. Në marrëveshjen e financimit është vendosur që fondet e këtyre donatorëve të menaxhohen si një financim i vetëm. Në fund të Dhjetorit 2016 rezultoi se për të gjithë financimin kanë përfunduar punimet në 57 akse rrugore me gjatësi prej 529 km. Deri në Dhjetor 2016 me këto fonde janë financuar 57 segmente rrugore në gjatësi totale prej 529 km. Gjatë vitit 2016, kanë qënë në zbatim 9 segmente rrugore ose 70 km. Ecuria e përgjithshme e gjithë projekteve ka qënë pozitive dhe mund të thuhet se standardet e reja të aplikuara në këtë projekt kanë dhënë rezultate të mira në lidhje me cilësinë e punimeve.

### **Rrugët e financuara nga KfW dhe IPA 2009**

KfW dhe IPA 2009 kanë financuar këtë program përkatësisht me 15 dhe 8.8 milionë Euro. Në marrëveshjen e financimit është vendosur që fondet e këtyre donatorëve të menaxhohen si një i vetëm. Me këto fonde ishte parashikuar financimi i rreth 90 km rrugë në Qarqet Kukës, Dibër dhe Shkodër. Në fund të vitit 2016 kanë përfunduar punimet në të gjitha segmentet e financuar nga ky donator.

*(Aneks 11.3 Informacion mbi nënprojektet e programit "Rrugët Dytësore & Lokale", financuar nga KfW & IPA 2009 (Dhjetor 2016)*

### **Rrugët e financuara nga Banka Islamike për Zhvillim dhe Qeveria Shqiptare (IDB & GoA)**

Banka Islamike për Zhvillim ka financuar Programin "Përmirësimi i Rrugëve Dytësore & Lokale" në shumën prej 40 milionë USD. Këtij financimi i është shtuar dhe një kontribut i Qeverisë Shqiptare në vlerën 4 milionë USD. Në Qershor 2016 kanë përfunduar punimet civile për 16 segmentet rrugore në një gjatësi prej 110 km. Në mbështetje të marrëveshjes së financimit me IDB, në fund të muajit Tetor 2016, FSHZH hartoi dhe ka dërguar pranë donatorit raportin përfundimtar të projektit.

**Konkluzione:**

Gjatë vitit 2016, programi ka paraqitur një performancë shumë të kënaqshme në të gjithë komponentët e tij.

Muaji Dhjetor 2016, shënoi përfundimin e punimeve në terren edhe për KfW dhe IPA 2009, duke përfunduar me sukses një nga programet me ambicioze në Shqipëri në këto 25 vitet e fundit.

FSHZH si agjenci implementuese e këtij programi ka kryer me sukses rolin e saj në monitorimin, koordinimin dhe implementimin e shpejtë të tij, duke garantuar realizimin me cilësi dhe përgjegjshmëri të të gjitha objektivave të zbatimit të programit.

Gjatë vitit 2016 në kuadër të zbatimit të këtij programi, FSHZH ka ndjekur zbatimin dhe periudhën e garancisë për rreth 37 segmente rrugore dhe ura. Që nga fillimi i zbatimit të PRRDL deri në fund të muajit Dhjetor 2016 janë financuar rreth 1,177 km rrugë dytësore dhe lokale në të gjithë vendin, duke plotësuar objektivat dhe pritshmëritë e programit.

Performanca shumë e mirë e këtij programi është vlerësuar edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare, të cilat përmes misionëve dhe raporteve të ndryshme e kanë vlerësuar maksimalisht atë.

#### 4. Programet e Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale

Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale është një program i bashkëfinancuar nga Qeveria Shqiptare, Banka Gjermane për Zhvillim, KfW, dhe Bashkimi Europian. I ndarë në disa projekte të veçanta ky program përbën një nga iniciativat më serioze të këtyre viteve të fundit për të përmirësuar furnizimin me ujë të pijshëm të zonave rurale. Ky program ka arritur deri më sot një financim total prej 56.76 milionë Euro. Përmes këtyre programeve përfitojnë më shumë se 135,000 banorë në zonat rurale, duke mundësuar kështu furnizim me ujë të pijshëm dhe higjienikisht të pastër. Gjatë muajit Nëntor 2015, ka filluar punën me përgatitjen e fizibiliteteve edhe programi FUZR III me një financim prej 39.3 milionë dhe shtrirje në gjithë Shqipërinë.

Programi	Kohë zgjatja	Financimi Euro (milion)	Qarqet ku implementohet	Popullsia që shërbehet me ujë (banorë)	Nr. i fshatrave
<b>RWSP I &amp; II</b>	2008-2016	11.66	Kukës, Dibër, Shkodër	40,000	53
<b>SIF IV</b>	2010-2017	5.8	Kukës, Dibër, Shkodër	20,000	23
<b>RWSP III</b>	2015-2019	39.3	Të gjitha Qarqet e Shqipërisë	75,000	70

##### 4.1 “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” , SIF IV

Në kuadër të programit SIF IV, financuar nga KfW në vlerën 5 milionë Euro dhe 0.8 milionë Euro të tjera, që janë kontribut lokal nga NJQV-të përfituese, u ndërtuan 15 skemave të ujësjellësave në Qarqet, Kukës, Shkodër dhe Dibër.

Është siguruar furnizim me ujë higjienikisht të pastër për rreth 20,000 banorë në zonat rurale në 23 fshatra të përqëndruar në 11 Njesi Administrative.


Programi ka një kohëzgjatje 6 vjeçare dhe përfundon në Qershor 2017.

Janë përgatitur Marrëveshjet Paraprake dhe Marrëveshjet Finale të Investimit me ish komunat përfituese, dhe u janë shpjeguar procedurat për pagesën e kontributit lokal. Kontributi lokal është mbledhur në masën 100 përqind.

Pas përfundimit të projekteve teknike në Janar 2014, u shpall tenderi parakualifikues dhe në fund të Marsit 2014, tenderi për punimet civile në 15 skemat e përzgjedhura për financim..

Në Qershor 2014 u shpall kompania fituese dhe në fund të muajit Qershor u lidh kontrata e zbatimit të projekteve për këto 15 rrjete ujësjellësash në Qarqet Dibër, Kukës, Shkodër. Në muajin Korrik 2014, kontraktori ka filluar zbatimin e punimeve.

Gjatë vitit 2015, kanë përfunduar punimet civile në 15 skema të ujësjellësave, dhe pjesa më e



madhe janë marrë në dorëzim provizor gjatë muajve Qershor-Korrik 2015. Skemat që kanë përfunduar gjatë tremujorit të fundit 2015, janë marrë në dorëzim nga NJQV-të e reja. Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2016, kontraktori është mobilizuar për riparimin e defekteve që mund të jenë gjeneruar gjatë kësaj periudhe, për punimet sanitare në 9 nga skemat ekzistuese, si dhe ka përfunduar punën për instalimin e matësive në Bajram Curri.

Në skemën e Komunës Gurrë u konstatuan probleme thelbësore sociale. Kështu FSHZH, së bashku me Komunën dhe aprovimin e donatorit, mori vendim që në këtë skemë të mos ndërhyhet. Në vijim u propozua dhe u ra dakord me KfW-në, që kjo skemë të zëvendësohet me skemën Bujan, Qarku Kukës. Konsulenti dorëzoi draft-projektin në Shkurt 2015 dhe projektin final në Mars 2015 i cili është kontrolluar nga Njësia e Kontrollit të Projekteve. Është aprovuar shtesa e kontratës për skemën Bujan në datë 29.06.2015. Muaji Dhjetor 2015, ka shënuar përfundimin e punimeve. Në fund të vitit 2016, progresi fizik i llogaritur i projektit në tërësi është në masën 100 përqind, duke konsideruar edhe punimet shtesë për nyjet sanitare.

Referuar Marrëveshjes së Investimit dhe komponenteve të saj të ndërhyrjes për masa sanitare emergjente, është ndërhyrë në 9 skema ku ishte investuar për ndërtimin e ujësjellësve. Sipas parashikimit zbatimi i përmirësimit të infrastrukturës sanitare në skemat e përzgjedhura ka përfunduar gjatë gjashtëmujorit të vitit 2016. Gjithashtu është rënë dakord në parim me donatorin, për pajisjen me matësia uji në qytetin e Bajram Currit, në mënyrë që të menaxhohet konsumi i ujit për skemat që varen nga furnizimi i linjës së transmetimit që furnizon këtë qytet. Punimet për vendosjen e matësive kanë përfunduar në Dhjetor 2016.

### **Ngritja e kapaciteteve në kuadrin e programit të Investimeve Sociale IV**

Gjatë vitit 2016, është avancuar me prokurimin për përzgjedhjen e kompanisë konsulente që po implementon programin e trajnimeve, në përshtatje me nevojat. Aktivitetet e trajnimit konsistojnë në trajnimin e rreth 15 trajnerëve të cilët janë staf i FSHZH-së, në mënyrë që t'i aftësojë ata për të trajnuar operatorët e njësive të qeverisjes vendore dhe stafit administrues dhe teknik të ndërmarrjeve të ujësjellësive, në mënyrë që të sigurohet një funksionim dhe mirëmbajtje e qëndrueshme e investimeve të programit SIF IV.

Në muajin Mars 2016 është lidhur kontrata me konsulencën ndërkombëtare dhe në Prill 2016, ka filluar mobilizimi i kompanisë konsulente. Kontrata e konsulencës do të zgjasë 15 muaj. KfW ka shtyre afatin e disbursimit për grantin që financon këtë kontratë. Pritet edhe miratimi nga Ministria e Financave në lidhje me shtyrjen e afatit të disbursimit.

### **4.2 “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”**

Projekti “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”, parashikon ndërhyrje në shkallë të gjërë në të gjithë vendin. Financues të këtij programi do të jenë KfW me 25.4 milionë Euro dhe Bashkimi Europian përmes IPA 2013, me 9.8 milionë Euro si dhe kontributi i Qeverisë Shqiptare.

Në këtë kuadër me financim nga WBIF në shumën 750,000 Euro, gjatë muajit Nëntor 2015, ka filluar puna me përgatitjen e fizibiliteteve teknike dhe sociale. Puna për hartimin e fizibiliteteve ka vijuar me intensitet edhe në 2016 dhe procesi i dorëzimit të tyre është mbyllur në Maj 2016. Në fund të këtij procesi janë administruar 252 aplikime nga 59 bashki. Bashkitë Elbasan dhe Konispol nuk kanë aplikuar në proces. Parashikohet që në fillim të vitit 2017 të ketë përfunduar përzgjedhja e projekteve që do të financohen.



Puna në terren për ndërtimin e ujësjellesave do të organizohet në Lot-e dhe parashikohet të fillojë në vitin 2017. Gjatë vitit 2017 do të fillojë puna për hartimin e projekteve teknike dhe punimeve civile, të cilat do të jenë të organizuara në Lot-e.

### **Prokurimi**

Gjatë muajit Mars 2014, u shpall tenderi ndërkombëtar për zbatimin e punimeve civile për 15 skemat e përzgjedhura për investim të programit SIF IV sipas procedurave përkatëse.

Në 2 Shkurt 2015, u publikua Tenderi Ndërkombëtar për studimin e fizibiliteteve teknike për RWSP III, ku morën pjesë 16 kompani. Gjatë procesit të vlerësimit, u parakualifikuan 5 kompani. Në datën 29 Qershor 2015, u paraqitën oferta teknike dhe financiare nga këto 5 kompani. Ka përfunduar vlerësimi i ofertave nga Agjenti tenderues dhe është shpallur kompania fituese për përgatitjen e fizibiliteteve teknike për këtë program. Muaji Nëntor 2015 ka shënuar fillimin e zbatimit të kontratës.

Në 6 Gusht 2015 është bërë publikimi për shprehje interesi për tenderin e përzgjedhjes së konsulencës ndërkombëtare për Aktivitete Trajnuese për Stafin Trajnues të FSHZH-së gjatë programit SIF IV. Ka përfunduar procesi i paravlerësimit, dhe janë përzgjedhur 2 kompani, për të vijuar me vlerësimin e ofertës financiare. Në 11 janar 2016, u bë hapja e ofertave dhe në muajin Shkurt 2016, është shpallur kompania fituese.

Gjatë muajit Prill 2016, u bë shpallja për tenderin parakualifikues të Projektim Supervizionit për Programin RWSP III. Në 23 Maj 2016, u paraqitën edhe ofertat nga 14 kompani. Vlerësimi do të bëhet nga një agjent tenderues i përcaktuar nga KfW.

Në 2 Dhjetor 2016, u hapën propozimet teknike nga kompanite e parakualifikuara, për tenderin e projektim supervizionit për fazën post kualifikuese për programin RWSP III. Vlerësimi do të bëhet nga një agjent tenderues i përcaktuar nga KfW.

### **Procedurat mjedisore**

Në kuadër të zbatimit të procedurave për mbrojtjen e mjedisit të programit "Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale", janë kryer këto aktivitete:

- Janë hartuar fizibilitetet mjedisore dhe Planet e Menaxhimit të Mjedisit për të gjitha skemat e ujësjellësve.
- Janë duke u ndjekur procedurat mjedisore dhe përgatitja e lejeve mjedisore për skemat e reja që u përfshinë me fondet e Programit SIF IV.
- Krahas përgatitjes së fizibiliteteve teknike dhe projekteve për skemat e përzgjedhura, vijon puna me procedurat për plotësimin me leje mjedisore si dhe lejen nga drejtoria e baseneve për përdorimin e burimeve ujore.
- Në lidhje me ndërhyrjet sanitare që do behen në 9 skema të programit SIF IV, është aplikuar për leje mjedisore dhe pritet të dalë së shpejti.

### **Konkluzione:**

Menaxhimi profesional dhe zbatimi programeve FUZR I dhe II, ka rezultuar me përfitimin e një financimi të dytë nga ana e KfW-së përmes Programit SIF IV, në vlerën prej 5.8 milionë Euro, çka ka mundësuar financimin e 15 skemave të reja ujësjellësash si dhe të ndërhyrjes në disa skema për masa sanitare emergjente.

Njëkohësisht në vijim të hartimit dhe zbatimit të programeve për ujësjellësa, është siguruar një financim nga WBIF në shumën 750,000 Euro, të cilat po përdoren për hartimin e fizibiliteteve teknike dhe sociale në kuadër të Programit të Ujësjellësive Rurale III, i cili parashikohet të ketë shtrirje në të gjithë vendin. Financues të këtij programi do të jenë KfW me 25.4 milionë Euro dhe Bashkimi Europian përmes IPA 2013, me 9.8 milionë Euro si dhe kontributi i Qeverisë Shqiptare.

## **5. Programi Punët në Komunitet IV “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonës Bregdetare”**

Objektivi i projektit “Punët në Komunitet IV - Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonës Bregdetare” është të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik në komunitetet me potencial të lartë turistik, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës së integruar publike duke respektuar ambientin dhe ruajtur trashëgiminë kulturore dhe historike.

Komponentët e projektit janë:

- investime në infrastrukturën dhe shërbimet lokale publike (rikualifikim urban e rrugë, ujësjellës-kanalizime, menaxhim i mbetjeve urbane, etj);
- asistencë teknike & ngritje kapacitetesh (studime fizibiliteti, përgatitje strategjish lokale, hartim projektsh, trajnime).

Projekti me vlerë 36.7 milionë Euro bashkëfinancohet nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës (CEB), Qeveria Shqiptare dhe NJQV-të përfituese, WBIF.

Burimet e financimit përfshijnë 28.7 milionë euro kredi nga CEB, 1 milion euro grant nga CEB Social Dividend Account (SDA), një kontribut 6 milionë euro nga Qeveria e Shqipërisë dhe NJQV përfituese, si dhe një 1 milion euro grant nga WBIF. Parashikohet që dy të tretat e kostos së Programit do të investohen në zonën bregdetare të Jugut dhe një e treta në zonën e Alpeve Shqiptare.

Marrëveshja midis Qeverisë Shqiptare dhe CEB për këtë projekt është firmosur në datë 21 Maj, 2015 dhe është ratifikuar nga Parlamenti në datë 2 Korrik 2015. Projekti, sipas marrëveshjes, ka filluar nga puna në tremujorin e fundit të vitit 2015 dhe parashikohet të përfundojë në shtator 2019.

Përsa i përket komponentit të zhvillimit të zonës bregdetare është lidhur kontrata e parë e punimeve rikualifikuese në Bashkinë e Vlorës dhe vijon puna me hartimin e projekteve teknike në projektet urbane në Vlorë dhe Himarë.

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti gjatë muajit Nëntor, është hapur në qytetin e Vlorës zyra e koordinimit të projektit, që do të koordinojë aktivitetin e projektit në Bregdetin e Jugut.

Përsa i përket komponentit të zhvillimit të zonës bregdetare është lidhur kontrata e parë e punimeve rikualifikuese në Bashkinë e Vlorës dhe vijon puna me hartimin e projekteve teknike në projektet urbane në Vlorë dhe Himarë.

Për Bashkinë Pukë po shqyrtohen ofertat e operatorëve ekonomike që do të përgatisin projektet e zbatimit. FSHZH ka kryer një punë voluminoze për përgatitjen e dokumentacionit dhe hartimin e projekteve teknike si më poshtë:

- Restaurimi i fasadave dhe rikualifikimi i qendrës së Gjirokastrës;
- Rikualifikimin urban dhe mjedisor të disa nënprojekteve në qendër të Pukës dhe te liqeni;
- Rikualifikim Urban në Bashkinë e Himarës, Faza e Parë;

- Rikualifikim urban në fshatrat e Dhërmiut dhe Vunoit;
- Rigjenerim urban të zonave bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi në bashkinë e Himarës;
- Rikonstruksion dhe ndërtimi i infrastruktures rrugore, parkimit dhe plazhit publik në Dhërleo;
- Rikualifikim Urban në Bashkinë e Vlorës, Faza e Parë;
- Rikonstruksioni i rrugës Port - Pylli i Sodes;
- Ndërtimi i rrugës lidhëse Dhimitër Konomi - Unaza - 7 Pallatet;

Në vitin 2015 janë hapur zyrat koordinuese në zonat e projektit.

Lidhur me pjesën e Alpeve ka përfunduar vlerësimi teknik për kompaninë konsulente ndërkombëtare, e cila do të hartojë Masterplanin e Alpeve dhe i është dërguar për miratim donatorit. Pas miratimit është bërë hapja e ofertave financiare dhe shpallja e fituesit. Gjatë tremujorit të parë ka filluar puna për hartimin e Masterplanit. Masterplani parashikohet të përfundojë në harkun kohor të 18 muajve.

Ky projekt financohet nga Banka për Zhvillim i Këshillit të Europës në kuadër të asistencës teknike të “Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor” (WBIF). Qëllimi kryesor i projektit të studimit të Alpeve është të ofrojë një plan zhvillimi social-ekonomik të qëndrueshëm për komunitetin e Alpeve Shqiptare si një nga zonat gjeografike me potencial të lartë të zhvillimit turistik. Produkt i studimit do të jenë veç njohurive të thelluara mbi zonën dhe potencialet e saj të zhvillimit edhe një numër projekt-propozimesh konkrete e studimesh fizibiliteti që do zbatohen në vazhdim.

Në terma konkretë studimi orientohet drejt këtyre produkteve:

- Vlerësim i Situatës Aktuale;
- Plan Kombëtar Sektorial i Turizmit;
- Propozim për Plan Marketingu;
- Program investimesh (Studime Fizibiliteti, projekte teknike) për projekte infrastrukturale lokale për kredite e ardhshme CEB.

Në muajin tetor 2016 u organizua takimi i parë me grupet e interesit për konsultimin e rezultateve paraprake të analizës së situatës aktuale të zonës në studim. Konsulenti ka përfunduar fazën e parë të studimit në lidhje me vlerësimin e situatës aktuale, dhe është duke intensifikuar punën për realizimin e fazës së dytë të kësaj kontrate, që përkon me hartimin e dokumentave të planifikimit:

- Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit të zonës e Alpeve Shqiptare dhe
- Plani Detajuar i Zonës me rëndësi kombëtare të zonës së Valbonës.

Në fund të muajit dhjetor FSHZH nisi kërkesën për nismë për hartimin e këtyre planeve. Më datë 29 dhjetor 2016 para Këshillit Kombëtar të Territorit u paraqitën për miratim të dy nismat e lartpërmendura.

## 6. Rikonstruksioni i rrugës së Lumit të Vlorës

Projekti parashikon ti japë zgjidhje të qëndrueshme infrastrukturës publike në zonën e Bregdetit të Jugut, specifikisht në zonën e Lumit të Vlorës, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës për vendasit dhe ridimensionim e sektorit të turizmit si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë lokale dhe rajonale.

Infrastruktura publike aktualisht nuk favorizon zhvillimin e ekonomisë dhe nuk ofron shërbime optimale për popullsinë vendase dhe turistët që frekuentojnë këtë zonë.

Projekti ka si qëllim rikonstruksionin e rrugës së Lumit të Vlorës, e cila do të mundësojë lidhjen e dy rrugëve nacionale (SH4-SH8) dhe përfshin edhe një degëzim që mundëson lidhjen me qytetin e Vlorës.

Rruga e Lumit të Vlorës në versionin fillestar të saj është parashikuar të financohet në shumën 78 milionë USD pa TVSH, për gjatësinë e plote të saj 94.2 km.

Pas negociatave me Fondin Kuvajtian është rënë dakort për financimin pjesor të rrugës, për gjatësinë 74 km me shumën 51 milionë pa TVSH (përfshijë 40 milionë USD kredi nga Fondi Kuvajtian dhe 11 milionë USD, kontribut i Qeverisë Shqiptare). Projekti parashikohet të fillojë në vitin 2017 dhe të përfundojë në vitin 2019.

Një mision vlerësues i Fondit Kuvajtian për Zhvillim Ekonomik Arab, vizitoi Shqipërinë për një periudhë 2 javore, nga 27 Shtatori deri në 10 Tetor 2015.

Qëllimi i kësaj vizite ishte diskutimi dhe vlerësimi mbi mundësinë e dhënies së kredisë për rikonstruksionin e Rrugës së Lumit të Vlorës, duke i hapur rrugë përgatitjes së Raportit Teknik i cili do të paraqitet për aprovim në mbledhjen e Bordit të Fondit Kuvajtian.

Gjatë vitit 2016, ka filluar puna për evidentimin e të gjitha hapave që duhet të ndërmerren, hartimin e grafikut të realizimit të projektit dhe përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm. Fillimisht u punua me përgatitjen e termave të referencës për Supervizionin e Punimeve, të cilat morën formën përfundimtare pas pasqyrimit të vërejtjeve dhe sugjerimeve të Fondit Kuvajtian dhe FSHZH.

Paralelisht është punuar me përgatitjen e dokumentave të tenderit për parakualifikimin, për punimet për Lotin e Parë. Procesi i tenderimit, shpallja e kompanisë fituese dhe fillimi i punimeve civile për Lotin e parë parashikohet të jetë gjatë muajit Shkurt 2017.

Në 30 mars 2016 u nënshkrua Marrëveshja e Kredise nga pala Kuvajtiane dhe Ministria e Financave.

Në këtë kuadër parashikohet që edhe Fondi Saudit për Zhvillim të financojë rreth 30 milionë USD që do të përdoren për financimin e pjesës e dytë të rrugës së Lumit të Vlorës, duke plotësuar kështu të gjithë financimin e nevojshëm për ndërtimin e rrugës. Në muajin shtator përfaqesues të Fondit Saudit për Zhvillim vizituan Shqipërinë dhe nënshkruan marrëveshjen e financimit.

## 7. Projekti për Zhvillim të Integruar Urban dhe Turistik (PZHIUT)

Prej fillimit të vitit 2016, FSHZH në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Urban ka zhvilluar një aktivitet intensiv për përgatitjen e projektit për Zhvillim të Integruar Urban dhe Turistik, i cili do të financohet nga Banka Botërore në vlerën 63 milionë Euro. Në shtator 2016 është nënshkruar marrëveshja e financimit.

Projekti parashikohet të fillojë në Janar 2017 dhe do të ketë një kohëzgjatje 5 vjeçare deri në Korrik 2022. Ai shtrihet në qendrat urbane të Sarandës, Gjirokastrës, Beratit, Përmetit dhe përgjatë korridorit turistik që kalon në këtë rajon. Nga ky projekt parashikohet të përfitojnë 84 mijë banorë dhe rreth 300 mijë turistë.

Objekti i projektit është përmirësimi i infrastrukturës urbane, nxitja e turizmit dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për të mbështetur turizmin dhe zhvillimin e ekonomisë lokale në zonat e përzgjedhura në jug të Shqipërisë.

Projekti do të ndikojë në zhvillimin e ekonomisë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në rajonin e jugor të vendit, nëpërmjet financimit të projekteve të infrastrukturës.

Komponenti 1. Projektimi urban dhe përmirësimi i infrastrukturës (44.3 milionë Euro)  
Financon hartimin e projekteve për zbatimin e projektimit urban dhe përmirësimin e infrastrukturës bashkiake në katër qendrat urbane: Saranda, Gjirokastra, Berati dhe Permeti. Investimet në këto bashki të përzgjedhura do të përfshijnë rehabilitimin e:

- hapësirave publike (psh, parqe, sheshe, pedonale);
- rrjet rrugor, nyje inter-modale dhe infrastruktura shoqëruese (p.sh , trotualet, kryqëzimet rrugore, ndriçimet rrugore, korsitë e biçikletave, stacionet e autobusëve);
- restaurimin e ndërtesave të përzgjedhura të trashëgimisë dhe përmirësimin e fasadave të ndërtesave të zgjedhura dhe;
- përmirësimin e zonave turistike (p.sh. rrugët hyrëse, qendrat e vizitorëve, vendparkimet, sinjalistika turistike).
- Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve do të mbështetet rast pas rasti.

Ky komponent do të financojë gjithashtu përgatitjen e projekteve urbane, studimeve të fizibilitetit, projekteve inxhinierike, dhe supervizimin e projekteve ndërtimore; Infrastruktura nëntokësore do të përfshihet si pjesë e përmirësimin të rrjetit rrugor, kur të jetë e nevojshme.

Komponenti 2. Përmirësimi i siteve turistike ( 8.4 milion Euro)

Financon investime që kanë për qëllim përmirësimin e siteve turistike që do të përzgjidhen përgjatë korridorit turistik në Shqipërinë e Jugut.

Investimet do përfshijnë restaurimin e objekteve të trashëgimisë dhe aseteve kulturore, përmirësimin e infrastrukturës mbështetëse. Ky komponent do të financojë gjithashtu përgatitjen e studimeve të fizibilitetit, planet e menaxhimit të siteve, projektet inxhinierike dhe supervizimin e projekteve ndërtimore.

Komponenti 3. Tregu i turizmit dhe zhvillimi i produkteve (7.7 milionë Euro)

Ky komponent do të financojë aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve për të përmirësuar menaxhimin bashkiak dhe zhvillimin ekonomik lokal të bazuar në turizëm. Me qëllim përsheptimit të aktivitetit të projektit, Qeveria Shqiptare përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 525, datë 20.7.2016 ka miratuar një financim prej 70 Milionë Lekë me TVSH.

Gjatë kësaj periudhe një ekip i FSHZH ka punuar intensivisht me ekipin e Bankës Botërore dhe MZHU për përgatitjen e gjithë dokumentacionit të nevojshëm (Dokumenti i Vlerësimit të Projektit, Plani i Prokurimeve, Dokumenti Kuadër për politikat Mjedisore e të Shpronësimeve, Manuali Operacional i projektit etj.) për aprovimin e projektit në Bordin e Bankës Botërore dhe në Qeverinë Shqiptare. Një sërë punësh përgatitore janë kryer për lehtësimin e fillimit të menjëhershëm të zbatimit të projekteve me miratimin e kredisë.

Vitin e parë të projektit parashikohet financimi i projekteve të konsideruara prioritare të konsideruara si fast-track:

- Rehabilitimi i rrugës këmbësore për në Kalanë e Beratit dhe pikës panoramike jugore të kalasë së Beratit "Tabja";

- Rikonstruksioni i rrugës automobilistike për në Kalanë e Beratit, rruga "Muzak Topia";
- Ndriçimi i rrugëve të qendrës së qytetit Gjirokastrë;
- Shtegu i Ali Pashait në Gjirokastrë dhe stabilizimi i themeleve të kalasë dhe rrugët e brendshme;
- Makineritë teknologjike për stacionin e transferimit të mbetjeve në Himarë;
- Rehabilitimi i shkollareve në qendrën e qytetit të Sarandës;
- Shëtitorja e Sarandës;

## 8. Programet e CBC/IPA (HERA), financuar nga BE dhe FSHZH

### 8.1 Vija bregdetare e qytetit të Vlorës - Lungomare

Kosto e këtij projekti është parashikuar në vlerën rreth 15 milionë Euro. Kjo kosto do të mbulohet përkatësisht nga IPA 2013, në vlerën 12 milionë Euro (11.3 milionë Euro punime civile & 0.7 milionë Euro supervizim) dhe 3 milionë Euro nga Qeveria Shqiptare. Punimet civile për realizimin e projektit kanë filluar Qershor 2015. Projekti është i ndarë në disa faza dhe është bashkerenduar me financime të tjera të Qeverisë Shqiptare, përmes Fondit për Zhvillimin e Rajoneve. Aktualisht ka përfunduar puna për mbushjen me rërë të plazhit Vlorë me fonde të Qeverisë Shqiptare në kuadër të FZHR 2014. Po me fonde të Qeverisë Shqiptare në kuadër të FZHR është në proces edhe gjelbërimi i vijës bregdetare të Vlorës. Të gjitha këto faza ecin paralelisht dhe ndiqen edhe nga punimet civile të ndërtimit të vijës. Hartimi i projektit teknik ka përfunduar dhe Delegacioni Europian hapi procedurat e tenderimit në 23 Mars. Është nënshkruar kontrata dhe punimet civile filluan në 12 Qershor 2015. Kohëzgjatja e punimeve është 16 muaj. Deri në Dhjetor 2016 punimet janë realizuar në masën 76 %.

### 8.2 Projekti HERA

HERA është akronimi i projektit të financuar nga programi IPA Adriatik të titulluar "Menaxhimi i qëndrueshëm i turizmit të trashëgimisë kulturore".

Projekti HERA konsistoi midis të tjerave në realizimin e projekteve pilot dhe promovimin e "Fototekës Marubi" në qytetin e Shkodrës, si një nga institucionet me vlera të mëdha kulturore, turistike dhe historike në Shqipëri.

Projekti synoi ruajtjen, pasqyrimin dhe promovimin e trashëgimisë fotografike shqiptare duke ofruar akses për publikun dhe të garantojë funksionalitet dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

Projekti ka pasur disa komponentë:

- Ndërtimi, restaurimi dhe mobilimi;
- Ruajtja e arkivës;
- Projekti muzeografik;
- Funksionaliteti dhe qëndrueshmeria e muzeut të ri.

Më datë 9 maj 2016, në Shkodër në ditën e Europës u përurua hapja e Muzeut Kombëtar Marubi. Pjesëmarrës në këtë ceremoni të hapjes ishte edhe Kryeministri i Shqipërisë, Z. Edi Rama.

Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi, u mundësua nga një iniciativë e përbashkët e Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Ministrisë së Kulturës me financimin e Qeverisë Shqiptare, Bashkimit Europian- Projekti HERA, Fondacionit Shqiptaro - Amerikan të Zhvillimit dhe Qeverisë Zviceriane gjatë periudhës 2013-2016.

Vlen për t'u theksuar se rëndësia dhe vlerat historike e kulturore të këtij projekti bënë bashkë një sërë aktorësh, individë, profesionistë dhe institucione vendase e të huaja.

### **8.3 IPA 2012 – Përmirësimi i aksesit në shërbimet publike për grupet vulnerable në zonat periferike në qytetet Tiranë dhe Durrës**

Shuma e financimit është 8 milionë Euro nga të cilat 6.2 financim i IPA kurse 1.8 milionë Euro është financim i dy bashkive të Tiranës dhe Durrësit.

Objektivi specifik i këtij projekti është përmirësimi i infrastrukturës sociale për grupet me vulnerabël në qytetet e Tiranës dhe Durrësit.

Në vijim të aktivitetit të zhvilluar gjatë vitit 2014, Projektet e financuara në Bashkitë Tiranë dhe Durrës, kanë filluar zbatimin në Janar 2015. Punimet janë parashikuar të zgjasin 18 muaj. Procedurat për monitorimin dhe supervizimin e punimeve civile ndiqen nga Delegacioni European. Në këtë projekt FSHZH paguan vetëm TVSH-në.

## 9. AKTIVITETI INSTITUCIONAL

### 9.1 Menaxhimi Financiar

Analiza financiare për vitin 2016, bazuar në sistemin raportues të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, jep informacion kryesisht mbi funksionet kryesore financiare: planifikimin, kontabilitetin, menaxhimin financiar të investimeve dhe atë operativ-administrativ.

Gjatë kësaj periudhe janë bërë përpjekje për ruajtjen dhe garantimin e ekuilibrave financiarë të institucionit në mënyrë që i gjithë aktiviteti ekonomik - financiar të jetë i organizuar brenda limiteve të lejuara të financimit. Gjithashtu vëmendje i është kushtuar administrimit dhe menaxhimit të fondeve me përgjegjshmëri dhe transparencë, si dhe monitorimit dhe mbikqyrjes së detajuar të fondeve sipas komponentëve përkatës: investime në infrastrukturë, administrim të brendshëm, asistencë teknike, etj.

Në kuadër të Programit “Rrugët Dytësore dhe Lokale”, Programit “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”, Programit “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare”, Programi “Projekti i Rehabilitimit të Rrugës së Lumit të Vlorës”, Projekti për Zhvillim të Integruar Urban dhe Ekonomik, Programit të Infrastrukturës Vendore/Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe Programeve IPA Adriatika, buxheti i miratuar për vitin 2016 është rreth 76 milionë Euro.

Me aktin normativ Nr.1, datë 29.07.2016 si dhe me aktin normativ 2 ,datë 16.12.2016 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.147/2015 “Për Buxhetin e vitit 2016”, buxheti i i FSHZH-së është rishikuar me ulje në vlerën 4,210 milionë Lekë. Pas rishikimit, buxheti i FSHZH-së për vitin 2016 është në vlerën rreth 46 milionë Euro.

### Realizimi i Buxhetit për vitin 2016

Kategoria	Grand Total/Totali i Përgjithshëm		
	Buxheti vjetor Euro	Realizimi per vitin 2016 ne Euro	%
Punime Civile	37,389,440	33,190,446	89%
Design&superv.	6,257,525	2,510,754	40%
Asistence Teknike	755,000	746,164	99%
Training	183,468	150,234	82%
Investime &PaisjeFZSHS	116,603	9,171	8%
Kosto Operative	1,568,670	1,378,922	88%
Rezerve	42,553	-	0%
<b>T o t a l i</b>	<b>46,282,546</b>	<b>37,985,691</b>	<b>82%</b>

Gjatë vitit 2016, buxheti i rishikuar është realizuar në masën 82% ose rreth 38 milionë Euro.

Investimet gjatë kësaj periudhe janë realizuar në masën 33.2 mln Euro ose rreth 89% e buxhetit të rishikuar. Në këtë kategori janë përfshirë dhe rreth 1.2 milion Euro pagesa direkte tek donatorët të dërguara në muajin Dhjetor të cilat nuk janë konfirmuar brenda datës 31.12.2016.

Ky nivel realizimi ka ardhur kryesisht për shkaqe objektive si pasojë e disa vonesave në miratimin e procedurave të pagesave dhe tenderimit nga Donatorët në fillim të projekteve të reja veçanërisht për Fondin Kuvjatjan dhe Banken e Keshillit të Europes (CEB). Për këtë arsye me Aktin normativ 2 buxheti i parashikuar për këta dy donatore ka pësuar ulje.



Ndërkohë ka patur vështirësi sidomos në realizimin e kontratave me institucione të treta. Realizimi fizik i punimeve në terren gjatë tremujorit të katërt ka avancuar me një ritëm me të lartë, për rrjedhojë disbursimi financiar në këtë periudhë ka qënë në nivele më të larta.

Për realizimin buxhetor janë ndjekur me përpikmëri plani i punës dhe procedurat e përcaktuara në marrëveshjet e nënshkruara me donatorët si dhe legjislacioni shqiptar.

Pasqyrat financiare, që paraqiten më poshtë, përmbajnë të dhëna të cilat krijojnë një skenar të qartë të mjedisit ekonomiko-financiar dhe të performancës së aktivitetit të FSHZH-së gjatë këtij viti, si dhe një analizë në nivelin strukturor të shpenzimeve dhe të të ardhurave duke paraqitur në këtë mënyrë raportin si dhe peshën specifike të donatorëve, kategorive dhe komponentëve të veçantë.

Gjatë këtij viti janë përgatitur Pasqyrat Financiare Vjetore (Bilanci) për vitin 2015 dhe në 08.03.2016 janë dërguar në Ministrinë e Financës sipas formatit dhe standarteve të kërkuara.

Në kuadër të Programit “Rrugët Dytësore dhe Lokale”, sipas kushteve të marrëveshjes me donatorët respektivë, është kryer procesi i auditimit të jashtëm nga kompania audituese “Deloitte & Touche” për donatorin EIB Grant për periudhën Korrik 2015- Dhjetor 2015 si dhe auditimi për periudhën Janar 2016-Korrik 2016. Gjithashtu është kryer procesi i auditimit të jashtëm nga kompania audituese “Deloitte & Touche” për donatorin KfW/IPA 2009 në kuadër të Programit “Rrugët Dytësore dhe Lokale” për periudhën Janar-Dhjetor 2015.

Lidhur me auditin e jashtëm për vitin 2015, gjatë muajit Shtator filloi procesi i auditimit nga kompania audituese Grant Thornton e përzgjedhur nga Ministria e Financës. Raportet janë çertifikuar dhe dorëzuar me Dhjetor 2016.

Në kuadër të PBA 2017-2019, sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.4 datë 29.02.2016 janë dërguar në afat kërkesat buxhetore dhe janë zhvilluar takime me Ministrinë e Financës lidhur me limitet e aprovuara dhe për kërkesat shtesë në dy fazat e përgatitjes së PBA-së.

Gjatë vitit 2016, FSHZH ka raportuar periodikisht pranë Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Integritetit etj., lidhur me:

- Monitorimin e investimeve publike, etj.;
- Disbursimet dhe shpenzimet sipas programeve dhe donatorëve respektive;
- Pagesat e kostove të bashkëfinancimit dhe TVSH të projekteve financuar nga programet cross border IPA Adriatika.

Gjatë vitit 2016, FSHZH ka menaxhuar fondet e akorduara nga donatorët e huaj dhe Qeveria Shqiptare që rrjedhin nga marrëveshjet qeveritare në kuadër të Programeve në zbatim dhe në kuadër të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve.

Aktualisht FSHZH ka në ndjekje financiare këto programe:

- Programi “Rrugët Dytësore dhe Lokale” - financuar Banka Botërore, CEB, OFID, IDB, ISTISNA, EIB, EBRD, IPA 2010-2011, KfW & IPA 2009 dhe Qeveria Shqiptare;
- Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” - financuar nga KfW, Qeveria Shqiptare dhe përfituesit e drejtpërdrejtë;
- Programi “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare “ financuar nga CEB, WBIF dhe Qeveria Shqiptare;
- Programi “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlores” financuar nga Fondi Kuvajtian;

- Programi “Projekti per Zhvillim te Integruar Urban dhe Turistik” financuar nga Banka Botërore.;
- Programi i Infrastrukturës Vendore në kuadër të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve dhe Investime te financuara 100% nga Qeveria Shqiptare.

### **Disbursimi i Fondeve gjatë vitit 2016 sipas Programeve**

Për periudhën Janar-Dhjetor 2016, në përputhje me kërkesat për financime, janë disbursuar nga donatorët e huaj rreth 14.97 milionë Euro sipas Programeve si më poshtë:

- *Për Programin “Rrugët Dytësore dhe Lokale”* - janë disbursuar rreth 11.77 milionë Euro nga të cilat: IDB & ISTISNA në vlerën 1.61 milion Euro, KfW SIF IV & IPA 2009 në vlerën 6.33 milion Euro, IPA 2010-2011 në vlerën 3.53 milion Euro, BEI Grant 259 mijë Euro, BERZH Grant 35 mijë Euro;
- *Për Programin “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare”* – janë disbursuar rreth 1.65 milion Euro nga të cilat : CEB kredi 1.5 milion Euro dhe EBIF Grant 150 mije Euro;
- *Për Programin “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale faza II-III-IV –janë disbursuar nga KfW 1.35 milion Euro;*
- *Për Programin “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” III* - janë disbursuar nga KfW 198 mijë Euro.

Pas rishikimit të buxhetit me Aktin normativ Nr.1, datë 29.07.2016 si dhe me aktin normativ Nr.2, datë 16.12.2016 “Per disa ndryshime ne ligjin Nr.147/2016 “Per Buxhetin e vitit 2016”, fondet e akorduara nga Qeveria Shqiptare për vitin 2016 për të dy programet në vazhdim dhe për programet e reja, në komponentët Investime, Kosto Lokale dhe TVSH janë në vlerën rreth 7 milionë Euro.

Fondet e planifikuara nga Qeveria Shqiptare në kuadër të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve për Programin e Infrastrukturës Vendore janë në vlerën rreth 20 milionë Euro.

### **Të ardhura të tjera**

Gjatë aktivitetit ekonomik-financiar të saj, FSHZH realizon të ardhura në vlera monetare nga aktivitetet dytësore dhe nga marrëveshjet e drejtpërdrejta me donatorë të ndryshëm. Gjatë vitit 2016 janë arkëtuar të ardhura nga aktiviteti dytësor dhe nga donatorët e huaj si më poshtë:

- Te ardhura nga shitja e dokumentave te tenderimeve 19 mijë Euro;
- Te ardhura nga interesa bankare 6 mijë Euro;
- Kontribute nga Bashkitë si bashkëfinancuese për projekte të financuara në kuadër të Programit të Furnizimit me Ujë rreth 16 mijë Euro;
- Kontribute nga Bashkitë si bashkëfinancuese për projekte te financuara ne kuader te Programit te Infrastrukturës Vendore Fondit të Zhvillimit të Rajoneve janë rreth 227 mijë Euro;
- Për Programet IPA Adriatika janë disbursuar rreth 102 mijë Euro në përputhje me kërkesat për financime për secilin program nga donatorët respektivë - IPA Hera dhe IPA Monteal. Si bashkefinancues te fototekes Marubi jane financuar nga Fondi Shqiptaro Amerikan i Zhvillimit rreth 172 mijë Euro dhe Fondi Zvicerian 9 mijë Euro. Gjithashtu ne kuader te programit te bashkepunimit nderkufitar jane financuar rreth 29 mijë Euro nga Fondi Norvegjez.

## Shpenzimet dhe Realizimi i Zërave të Buxhetit të Rishikuar për vitin 2016

Gjatë vitit 2016, FSHZH ka menaxhuar një fond prej rreth 38 milionë Euro, me një realizim financiar në masën 82% kundrejt buxhetit vjetor të rishikuar. Realizimi financiar paraqitet më poshtë i ndarë sipas komponentëve:

### Infrastruktura

Ky zë përbën aktivitetin kryesor të Institucionit dhe përfaqëson investimet në infrastrukturë për punime civile për rikonstruksion dhe përmirësim të infrastrukturës rrugore, gjelbërim të infrastrukturës rrugore dhe objekteve të tjera, rehabilitim të zonave urbane, rehabilitim dhe ndërtim të ujësjellësave ruralë dhe shkollave, restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe të tjera. Në këtë komponent është ndjekur zbatimi i punimeve dhe i periudhës së garancisë për rreth 107 kontrata punimesh civile. Si komponent është realizuar në vlerën rreth 33.20 milionë Euro ose në masën prej 89% kundrejt buxhetit vjetor, përfshirë dhe kërkesat për disbursim të dërguara te donatorët respektive.

(Tabela bashkëngjitur “Realizimi i zërave të Buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2016”).

### Realizimi financiar për periudhën Janar–Dhjetor 2016 për kategorinë “Investime”

Programet	Pesha specifike në % kundrejt realizimit	Realizimi në vlerë (shprehur në Euro)
Programi i Rrugeve Dytësore dhe Lokale (OPEC,EIB,EBRD,IPA 2010-2011,IDB-Istisna ,KfW IPA 2009)	43%	14,362,496
PKIV-Zhvillimi.Alp.Shqiptare Zona Bregdetare	1%	241,378
Programi i Ujesjellsave Rurale (KfW/SIFIV)	3%	905,127
Investime Qeveria Shqiptare+TVSH+FZHR	51%	17,062,467
Perfituesit+Fondet e FSHZH-se	2%	618,978
<b>Totali</b>	<b>100%</b>	<b>33,190,446</b>

### Projektim – Supervizimi

Gjatë vitit 2016, ky zë është realizuar në vlerën rreth 2.51 milion euro ose 40% kundrejt buxhetit vjetor të rishikuar dhe përfshin shpenzime për projektim dhe supervizion të punimeve civile sipas programeve përkatëse. Në kuadër të Programit “Rrugët Dytësore dhe Lokale” janë disbursuar rreth 299 mijë Euro për financimin e kontratës së supervizionit me kompaninë IRD Engineering. Në kuadër të programeve “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale faza II-SIF IV” janë disbursuar rreth 293 mijë Euro për financimin e kontratës me kompaninë Kocks Consult. Në kuadër të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve në këtë kategori janë disbursuar rreth 1.48 milion Euro për financimin e programeve për “Hartimi i projekt-ideve dhe projekteve të zbatimit për transformim dhe përmirësim të hapësirës urbane në disa zona në rajonet Tiranë - Durrës dhe Bregdetin e Jugut”, “Hartimi i studimeve dhe projekt ideve per projekte komplekse urbane”, “Hartimi i Master Planit të Parkut të Liqenit të Tiranës dhe Projektimi për Ishullin e Osumit Berat” si dhe për financimin e supervizionit dhe kolaudimit të projekteve të infrastrukturës vendore. Gjithashtu, në kuadër të Programit “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare” janë financuar rreth 401 mijë Euro financuar per financimin e kontratave te projektimit si dhe rreth 38 mijë Euro në kuadër të projekteve IPA Adriatik për supervizionin e punimeve të fototekës Marubi.

### Asistenca Teknike

Ky komponent është realizuar në vlerën 746 mijë Euro ose në masën 99% kundrejt buxhetit vjetor të rishikuar. Ky zë përfshin asistencë teknike të huaj për menaxhimin e kontratave të punimeve, ndjekjes së procedurave të prokurimeve sipas standarteve të çdo donatori dhe mirëmbajtjes rrugore dhe ujesjellsave. Në këtë komponent janë financuar rreth 464 mijë Euro në kuadër të Programit “Rrugët Dytësore dhe Lokale”, rreth 84 mijë Euro në kuadër të Programit IPA Adriatika për restaurimin dhe muzealizimin e Fototekës Marubi financuar nga IPA Hera, si dhe rreth 198 mijë Euro në kuadër të Programit “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III” financuar nga KFW.

### Kualifikime

Ky komponent përfshin shpenzimet e bëra për kualifikimin e stafit të FSHZH-së dhe të komunave dhe bashkive. Ky zë është realizuar në vlerën 150 mijë Euro ose në masën 82% kundrejt buxhetit vjetor të rishikuar. Shpenzimet e kryera në këtë zë janë kryesisht në kuadër të projekteve IPA për aktivitete të ndryshme, për promovimin e vlerave të zonave turistike dhe për kualifikime me temë “Zhvillimi Ekonomik Lokal” për stafet të komunave dhe bashkive, si dhe shërbim konsulence për zhvillimin e aktiviteteve të trajnimit për stafin e FSHZH-se në kuadër mirëmbajtjes dhe funksionimit të ujesjellsave rurale të financuar nga KFW Grant.

### Shpenzime operative

Shpenzimet operative gjatë vitit 2016 janë realizuar në vlerën 190 milionë Lekë ose rreth 88% kundrejt buxhetit vjetor të rishikuar.

Realizimi i zërave të shpenzimeve të nënkomponentëve të kësaj kategorie kundrejt buxhetit vjetor të rishikuar është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

#### Realizimi i shpenzimeve operative kundrejt buxhetit vjetor 2016

##### Analiza e shpenzimeve të kostos operative

REALIZIMI KUNDREJT BUXHETIT 2016 (Kosto operacionale) Lekë				
Nr.	Zërat	Buxhet 2016	Realizimi vjetor 2016	Përqindja e Realizimit
1	Kanceleri	2,500,000	2,500,000	100%
2	Karburant	10,500,000	8,749,149	83%
3	Servis makinash/siguracion	6,000,000	5,041,276	84%
4	Pagat	165,000,000	152,170,196	92%
5	Dieta	4,300,000	2,741,698	64%
6	Telefon dhe PT	3,000,000	1,909,376	64%
7	Internet	1,000,000	783,067	78%
8	Energji Elektrike/Uje	2,500,000	1,994,381	80%
9	Zyra me qera	3,000,000	2,130,414	71%
10	Mirembajtje/Sigurim godine	4,000,000	3,900,120	98%
11	Te tjera/Petty cash	4,000,000	3,919,342	98%
12	Publikimi & Promovime	4,000,000	1,613,638	40%
13	Kontrata Sherbimi	2,000,000	1,760,832	88%
14	Shp. gjyqesore/perkthime	3,720,000	152,332	4%
15	Servis kompjuter dhe fotokopje	700,000	700,000	100%
	<b>TOTAL</b>	<b>216,220,000</b>	<b>190,065,821</b>	<b>88%</b>

*a. Shpenzimet për kancelari*

Shpenzimet kryesore në këtë zë janë kryesisht për kancelari të ndryshme, letër, bojra për fotokopje dhe printera, etj. Gjatë këtij viti janë shpenzuar rreth 2.5 milion lekë ose 100 % e buxhetit vjetor për blerje materjale zyre dhe kancelarie.

*b. Shpenzimet për karburant*

Buxheti vjetor për këtë zë të shpenzimeve është 10.5 milionë Lekë. Gjatë këtij viti janë shpenzuar 8.74 milion lekë ose 83% e buxhetit vjetor për blerje karburanti në mbështetje kryesisht të aktivitetit të kryer nga Departamenti i Infrastrukturës për mbikqyrjen e objekteve në terren.

*c. Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe siguracion të automjeteve*

Këto shpenzime përfshijnë shërbimet periodike, shërbimet e veçanta, blerjen e pjesëve të këmbimit, gomave dhe siguracionin e mjeteve. Buxheti i parashikuar për këtë zë është rreth 6 milionë lekë. Realizimi për këtë vit është rreth 5.04 milion lekë ose në masën 84% të buxhetit vjetor.

*d. Shpenzimet për paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore*

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore për vitin 2016 janë parashikuar në shumën 165 milionë lekë. Ky zë është realizuar në masën 92% kundrejt buxhetit vjetor.

*e. Shpenzimet për dieta e shërbime*

Shpenzimet për dieta dhe shërbime për vitin 2016 janë parashikuar në shumën 4.30 milionë lekë. Ky zë shpenzimesh është realizuar në vlerën 2.74 milion lekë ose 64% kundrejt buxhetit vjetor dhe mbështet kryesisht aktivitetin e kryer nga Departamenti i Infrastrukturës për mbikqyrjen e objekteve në terren.

*f. Shpenzimet e komunikimit*

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për komunikim si dhe shpenzimet e shërbimit postar. Ky zë është parashikuar 3 milionë lekë dhe është realizuar në vlerën 1.90 milion lekë ose 64% kundrejt buxhetit vjetor.

*g. Shpenzime të tjera*

Në zërin shpenzime të tjera përfshihen shërbim interneti, facilitete dhe qera rajonale të FSHZH-së, energji elektrike, ujë, ruajtje e godinës, mirëmbajtje e sistemeve të zyrave qendrore, siguracione, seminare të stafit, blerje të vogla etj. Për këtë zë në Buxhetin 2016 janë parashikuar rreth 14.5 milionë lekë. Ky zë është realizuar në vlerën 12.72 milionë lekë ose 88 % kundrejt buxhetit vjetor.

*h. Publikime & Promovime*

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për analizat periodike të stafit, dizajne, printime, publikime dhe njoftime të ndryshme në shtyp (njoftime për tendera, punësime, etj). Në buxhetin e vitit 2016 për këtë zë janë parashikuar rreth 4 milionë Lekë. Gjatë këtij viti janë realizuar shpenzime në masen 1.61 milione leke ose rreth 40% kundrejt buxhetit vjetor të parashikuar për këtë zë për njoftime, publikime, përgatitje video dhe dokumentarë kryesisht në kuadër të projekteve IPA Adriatika.

*i. Kontrata shërbimi dhe shpenzime gjyqësore, përkthime, noterizime*

Në këtë zë përfshihen shpenzime gjyqësore dhe asistencë juridike si dhe pagesa për kontrata shërbimi. Për këtë zë në buxhetin 2016 janë parashikuar rreth 5.72 milionë lekë. Gjatë këtij viti, shpenzimet për këtë zë janë në vlerën 1.91 milion lekë ose 33.44 % kundrejt buxhetit vjetor.

*j. Servis kompjuter dhe fotokopje*

Në buxhetin e vitit 2016 për këtë zë janë parashikuar rreth 700 mijë Lekë per mirembajtjen e pajisjeve kompjuterike dhe fotokopjeve. Shpenzimet për këtë zë janë realizuar 100%

## 9.2 Komunikimi dhe Informimi

Komunikimi dhe Informimi është një aspekt mjaft i rëndësishëm i punës së Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Arritjet e deritanishme të FSHZH-së, dhe veçanërisht intensiteti i lartë i projekteve dhe investimeve për këtë periudhë nëpërmjet një strategjie komunikimi të mirëpërcaktuar i janë komunikuar një publiku më të gjerë.

Gjatë vitit 2016, krahas aktiviteteve promovuese dhe informuese mbi Programin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale dhe Programin e Ujësjiellësve Rural, FSHZH ka zhvilluar aktivitete promovuese edhe për projektin HERA: “Menaxhimi i turizmit të qëndrueshëm të trashëgimisë së vendeve të rajonit të Adriatikut”, Programin Punët në Komunitet IV, si dhe investime që kanë në fokus zhvillimin dhe rivitalizimin urban, në zbatim të Programit të Qeverisë Shqiptarë për Rilindjen Urbane, duke e rritur edhe spektrin e përfituesve të drejtpërdrejtë nga investimet e FSHZH-së. Me qëllim monitorimin e investimeve dhe koordinimin me agjencitë e tjera qendrore, vendore dhe rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka çelur në nëntor 2015 dy zyra rajonale, përkatësisht, në Gjakovë dhe Vlorë; aktivitetet e të cilave kanë gjetur pasqyrim në faqen zyrtare të web-it dhe në FB.

Në përputhje me Strategjinë e Komunikimit të FSHZH-së dhe mbështetur mbi buxhetin vjetor me synim rritjen e vizibilitetit të projekteve që zbatohen nga FSHZH janë përgatitur komunikata për shtyp për inspektimet e kryera nga stafi drejtues i FSHZH-së si dhe janë pasqyruar në Facebook dhe faqen zyrtare të internetit vizitat e përfaqësuesve të qeverisjes qendrore në sitet e projekteve që po zbatohen nga FSHZH; Informimi i publikut gjatë vitit 2016 është realizuar në këto drejtime:

- **Mediat vizive**

Aktiviteti i FSHZH-së ka qenë prezent në median vizive nëpërmjet pasqyrimin të kronikave për Projektin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale, Projektin e Ujësjiellësve Rural III, Projektin HERA, si dhe projektet e reja që po zbatohen nga FSHZH me financim nga Qeveria Shqiptare nëpërmjet Fondit për Zhvillimin e Rajoneve. Gjatë kësaj periudhe janë transmetuar kronika mbi aktivitetet e FSHZH-së në televizionet kombëtare si Top Channel, Klan TV, ABC News, Ora News, A1 Report TV, RTSH, si dhe në televizionet lokale si, TV1 Channel, Rozafa TV etj.

- **Shtypi i shkruar**

Përveç mbulimit televiziv të aktivitetit, paralelisht është bërë edhe pasqyrimi i aktivitetit të FSHZH-së në shtypin e shkruar. Vëmendje i është kushtuar nga media e shkruar projekteve të reja që po implementohen nga FSHZH në kuadër të investimeve nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve pasi këto investime fokusohen në rivitalizimin e qendrave urbane. Artikuj mbi investimet e FSHZH-së janë pasqyruar në revista, gazeta, si dhe media elektronike si p.sh., gazeta Panorama, Shqiptarja.com, Shekulli, Balkanweb, ATSH, Newsbomb.al, etj.

- **Faqja zyrtare e web-it**

I gjithë aktiviteti në kuadër të informimit të publikut është pasqyruar me detaje e imazhe në faqen zyrtare të web-it të FSHZH në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Gjatë kësaj periudhe janë pasqyruar rreth 6 lajme në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Është bërë përditësimi i vazhdueshëm i informacionit si dhe pasqyrimi i përshkrimeve në shqip dhe anglisht të projekteve të reja në zbatim. Gjatë këtij viti është bërë edhe një fushatë sensibilizuese për fillimin e Projektit të Ujësjiellësve Rural III. Fushatë e cila është pasqyruar në gjuhën shqipe dhe angleze në faqen zyrtare të internetit.

- **Faqja zyrtare Facebook**

I gjithë aktiviteti i FSHZH në kuadër të informimit të publikut është pasqyruar me detaje, në imazhe e video dhe në faqen zyrtare të Facebook-ut. Në këtë faqe përveç publikimeve të aktiviteteve të FSHZH është bërë një komunikim interaktiv i personave të interesuar jo vetëm me postime në murin e kësaj faqeje, por dhe me komente të ndryshme të investimeve të kryera si dhe atyre të reja. Gjatë kësaj periudhe në FB janë pasqyruar disa dhjetra postime të reja. Numri i ndjekësve të FB ka ardhur duke u rritur, çka shpjegohet me pasqyrimin e investimeve që kanë një interes të madh publik si projekti për ndërtimin e shëtitores së Vlorës, për ecurinë e projektit për Restaurimin dhe Muzealizimin e Fototekës Kombëtare Marubi, fillimi i zbatimit të Programit të Ujësllësve Rural III, në kuadër të të cilit janë zhvilluar disa seminare që kanë gjetur pasqyrim të gjërë në FB.

### **9.3 Monitorimi dhe Vlerësimi**

Gjatë vitit 2016, ka vijuar puna për monitorimin e ecurisë së programeve kryesore në zbatim nga FSHZH. Monitorimi i ecurisë së Programit të Rrugëve Dytësore & Lokale në të gjithë elementët e tij, ka qenë një ndër aktivitetet kryesore të sektorit të Monitorim – Vlerësimi. Puna për monitorimin e programit ka konsistuar në marrjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi ecurinë e nënprojekteve për të gjitha fazat e investimit dhe të gjithë Donatorët. Është bërë monitorimi i indikatorëve të ecurisë së projektit, duke përfshirë avancimin teknik dhe atë financiar. Në kuadër të monitorimit të këtij programi, janë përgatitur raporte të monitorimit të programit. Me kërkesë të donatorëve që kanë financuar këtë program, ministrive të linjës dhe të interesuarve të tjerë janë dërguar informacione që lidhen me ecurinë dhe indikatorët e performancës.

Monitorimi i Programit “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” ka ndjekur treguesit periodikë të komponentëve kryesorë të tij duke i krahasuar me planet e punës, dhe ka vërejtur përgjithësisht një ecuri të mirë të këtij programi. Gjatë kësaj periudhe puna është fokusuar në monitorimin e indikatorëve bazë të programit, deri në këtë fazë të zbatimit të tij. Konstatohet se programi paraqet performancë pozitive.

Vëmendje i është kushtuar edhe Fondit të Zhvillimit të Rajoneve dhe projekteve të tjera në zbatim ose fazë përgatitore.

#### 9.4 Auditimi i brendshëm

NJAB zhvillon aktivitetin bazuar në planin vjetor të Auditimit të miratuar në KD, në programin e auditimit të miratuar nga DE për çdo mision auditimi dhe në standartet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm International Professional Practices Framework (IPPF) të miratuar nga "The Institute of Internal Audit" (IIA). Treguesit kryesore të performancës së NJAB si dhe konkluzionet më kryesore të veprimtarisë audituese janë si më poshtë:

#### Treguesit kryesore të performancës së Auditimit të Brendshëm

Gjatë vitit 2016, auditimi i brendshëm i FSHZH ka realizuar objektivat e parashikuara në planin e auditimit, të miratuar në KD. Treguesit kryesore të performancës së auditimit janë:

- Realizimi i planit të auditimit të miratuar në Këshillin Drejtues në masën 110%. Konkretisht: janë realizuar: 5 misione auditimi (4 auditime të fazave të ciklit të projekteve dhe 1 auditim sistemi) si dhe 5 raportime auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga AB nga 4 të programuar.
- Realizmi i treguesve sasiorë, lidhur me përfshirjen në testim, është në masën 103%. Konkretisht, janë përfshirë në proces auditimi dhe testuar: *rreth \$ 42,7 milion, ose 31 % e fondeve të disbursuar dhe të përfshira në auditim. Është testuar dokumentacioni tekniko-financiar dhe janë kontrolluar në terren 21 nënprojekte, 165 mijë m<sup>2</sup> sheshe urbane, 86 970 ml ujësjellës, 27.3 km rrugë. Janë përfshirë në auditim të gjitha strukturat menaxhuese të FSHZH dhe gjithë projektet në zbatim.*
- Objektivi i parashikuar mbi mbulimin e riskut në proces auditimi si dhe përfshirjen e gjithë aktivitetit të fondit, është realizuar në masë të plotë. U audituan faza të veçanta të zbatimit të vlerësuara me risk të konsiderueshëm si dhe u realizua një auditim i plotë mbi sistemin e menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm në FSHZH.
- Objektivi i cilësisë dhe rezultateve të veprimtarisë auditit, i cili parashkonte që asnjë risk i rëndësishëm për FSHZH apo rast abuzimi apo korrupsioni, të mos mbetet pa u zbuluar dhe raportuar nga auditi, është përmbushur plotësisht. (audituesit e KLSH dhe të kompanisë auditimit financiar ndërkombëtar Grant Thornton, nuk kanë konstatuar asnjë rast të keqmenaxhimit të fondeve)
- Rekomandimet e NJAB janë pranuar nga menaxhimi në masën 100%, ku 49 % prej tyre janë zbatuar ndersa 51% janë në proces zbatimi.

#### Konkluzionet kryesore mbi menaxhimin dhe kontrollin e brendshëm në FSHZH

Në përfundim të aktivitetit të auditimit për vitin 2016, NJAB konstaton se:

- FSHZH ka ngritur sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm të cilat kanë funksionuar me efikasitet dhe efektivitet duke siguruar arritjen e objektivave të parashikuara për gjithë institucionin dhe çdo projekt/program në veçanti. Risqet e projekt/programave janë identifikuar dhe monitoruar në kohën e duhur.
- Megjithatë, sistemi ekzistues i menaxhimit nuk mund t'i përgjigjej me efikasitet sfidave dhe kompleksitetit që paraqesin projektet e reja të cilat po implementohen në FSHZH. (Projekti i Zhvillimit të Intergruar Urban dhe Turistik, i BB, Projekti i Punëve në Komunitet IV, i CEB, Projekti i FUZR III si dhe Projektet e QSH). AB, pasi bëri një analizë të detajuar të 5 komponentëve të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm (referuar strukturës sipas "The Committee of Sponsoring Organizations of the Treadway Commission"(COSO), vlerësoi riskun dhe impaktin e mangësive për çdo komponent në arritjen e objektivave dhe



rekomandoi përmirësimet përkatëse. Ngritja e sistemeve të përshtashëm të manaxhimit që në fazat fillestare të zbatimit të projekteve është thelbësore për arritjen e objektivave.

Aktualisht, janë zbatuar një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve të AB, lidhur me përmirësimet në MP dhe strukturën organizative të FSHZH, (ndryshimet e miratuara nga KD në mbledhjen e muajit Dhjetor) dhe pjesa tjetër e tyre janë në proces. (po punohet me ripunimin e manualeve të veçantë të projekt/programeve).

- Sistemi i mbikqyrjes së projekteve, vlerësohet me këto mangësi: i) në projektet e financuara nga QSH, performanca e supervisorëve është e ulët dhe nuk garantojnë menaxhimin e riskut të mbartur nga faza e projektimit. ii) afati i kontratës i parashikuar, në bazë të standarteve tona, nuk mbulon periudhën e garancisë së objekteve, iii) nga testimet e AB konstatohen punime jashtë standarteve apo pasaktësi në dokumentacion në vlerën 2.030 mijë leke ose 0.26% të fondeve të testuara.

Këto mangësi riskojnë standartet e punimeve civile dhe qendrushmerinë e investimit.

Rekomandimet e AB janë; shërbimi i projektim – supervizimit të realizohet nga kompani me kapacitete profesionale të kompletuara (specialist mjedisi, specialist për studime gjeologjike), për të garatuar standartet e kërkuara të projektimit dhe mbikqyrjes. Koha e kontratës të mbulojë edhe periudhën e garancisë së punimeve.

- Sistemi i kontrollit mbi sigurinë rrugore vlerësohet me këto mangësi; i) performanca e ulët në fazën e projektimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit, ii) mungesa e standarteve të përditësuara të sigurisë rrugore, iii) mungesa e audituesve të çertifikuar, për sigurinë rrugore.

Risku vlerësohet i lartë pasi janë konstatuar probleme në më tepër se 90% e objekteve të testuara, duke sjellë aksidente rrugore dhe rrezikuar jetën e qytetarëve.

Rekomandimi i AB është; të mundësohet auditimi i sigurisë rrugore, referuar standarteve (jo projektit teknik), shërbim i cili mund të jetë pjesë e kontratës së kolaudimit për projektet e QSH dhe e supervizimit për projekte me donatorët.

- Mangësi dhe pamjaftueshmëri në sistemet e menaxhimit të projekteve të integruar të zhvillimit, të cilat përfaqësojnë perspektivën e zhvillimit të vendit. Menaxhimi i projekteve të integruara kërkon sisteme të integruara, pra që tejkalojnë sistemin e ngritur brenda një institucioni. AB ka konstatuar vonesa dhe mangësi në realizimin e projekteve të përbashkët me ministri të caktuara; institucione të tjera apo bashkëpunuese.

Risku i bashkëpunimit ndërinstitucional, vlerësohet të jetë i lartë pasi impakton realizimin e buxhetit të parashikuar veçanërisht për një sërë projektesh të QSH si dhe efikasitetin dhe efektivitetin e projekteve, sic është Projekti i zhvillimit të integruar urban i BB.

Rekomandimi i AB është ngritja dhe forcimi i sistemeve të integruara. Konkretisht; i) përgatitja e marreveshjeve të bashkëpunimit me detyra, përgjegjësi dhe afate konkrete të realizimit të projekteve; si dhe ii) forcimi i monitorimit dhe kontrollit nga strukturat monitoruese të projekt/programeve. Bashkëpunimi midis institucioneve nuk duhet të jetë vetëm në nivel vullneti por të ngrihet në nivel profesional dhe të sigurojnë sinergjinë e duhur për arritjen e objektivave.

## 9.5 Misione të donatorëve

- **Mision i Bankës Europiane të Investimeve (EIB), në kuadër të Programit të “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”**

Një mision vlerësimi i Bankës Europiane të Investimeve (EIB), vizitoi Shqipërinë në në Korrik 2016. Qëllimi i këtij misioni ishte vlerësimi i ecurisë së financimeve të kryera nga EIB, EBRD, IPA 2010-2011 dhe WBIF në kuadër të Programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”.

Gjatë qëndrimit të tij, misioni zhvilloi një sërë takimesh me stafin e FSHZH. Në fokus të diskutimeve të misionit ishin, ecuria e punimeve civile, supervizioni, asistenca teknike, kostot, financimi dhe raportimi.

Në fund të tij, misioni konstatoi se projekti ka pasur progres të mirë gjatë zbatimit të tij. Ai parashikohet të respektojë buxhetin e akorduar dhe kohën e përfundimit, me rezultate plotësisht të kënaqshme.

- **Misione të Bankës Gjermane për Zhvillim KfW në kuadër të Projekteve FUZR III dhe SIF IV, për komponentet e Ujësjetësave Ruralë dhe Rrugëve Dytësore dhe Lokale**

Misioni i parë është kryer gjatë periudhës nga 9 - 13 Maj 2016

Misioni i dytë është kryer gjatë periudhës nga 15 - 19 Gusht 2016

Qëllimi i këtyre misioneve ka qenë vlerësimi i Programit SIF IV duke përfshirë komponentin e rrugëve dhe atë të ujësjetësave, por edhe ecurinë e programit Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale faza III. Gjatë këtyre misioneve u organizuan takime me stafin e FSHZH-së. Njëkohësisht janë organizuar vizita në terren për të parë nga afër ecurinë e deritanishme të projekteve në zbatim. Misionet në fjalë vlerësuan mjaft pozitivisht progresin e bërë nga projektet duke theksuar se janë realizuar më së miri objektivat për të cilat ato janë financuar.

Misioni i parë i KfW për vitin 2016 u zhvillua në periudhën 3-13 Maj. Fokusi i këtij misioni ishte ecuria e programit SIF IV për komponentin e ujësjetësave dhe rrugëve dytësore dhe lokale. Gjatë takimeve të zhvilluara me stafin e FSHZH, u diskutua mbi ecurinë e projekteve të financuara, segmentet rrugore Kukës - Shishtavec Lot II dhe III, Rruga nacionale - Qelëz, Rruga nacionale – Iballë Lot I dhe II, dhe segmenti rrugor Tamarë – Vermosh Lot I dhe II. Pjesë e diskutimeve të këtij misioni ishin edhe ujësjetësat e fshatrave Novosej, Topojan dhe Dragoç. Disa nga detyrat e lëna ishin adresimi, raportimi dhe zgjidhja e problematikave të mirëmbajtjes, dorëzimi i objekteve pranë ARrSh, siguria rrugore, shtyrja e afateve të kontratës së supervizionit, etj.

Lidhur me komponentin e ujësjetësave të financuar në kuadër të SIF IV, misioni diskutoi mbi çështje të lidhura me monitorimin e performancës së ujësjetësave, mbledhjen e të dhënave dhe disburimin e fondeve. Misioni mori në shqyrtim edhe mbi ecurinë e programit Furnizimi me Ujë të Zonave Rurale faza III.

Misioni i dytë i KfW, u zhvillua në 15-19 Gusht 2016. Gjatë misionit u diskutua mbi mbylljen e programit SIF IV si dhe për programin e ri FUZR III, për përgatitjen e studimeve të fizibiliteteve dhe me zhvillimin e komponenteve të tjera të programit, si tenderimi i projektimit etj. Lidhur me komponentin e rrugëve në kuadër të SIF IV, u diskutua mbi ecurinë e punimeve. Gjatë këtij misioni u zhvilluan vizita në terren në disa prej nga objektet e financuara.

## 10. AKTIVITETE TE TJERA

### 10.1 Përgatitja dhe aplikimi për projekte të reja

Një nga aktivitetet e rëndësishme e zhvilluar paralelisht me punën për zbatimin e projekteve të investimeve është dhe vlerësimi i nevojave dhe përgatitja e projekteve të reja, aplikimi pranë donatorëve dhe sigurimi i fondeve për financim. Gjatë kësaj periudhe FSHZH është angazhuar për përgatitjen dhe inicimin e Projektit për Zhvillim të Integruar Urban dhe Ekonomik. Ky projekt do të financohet nga Banka Botërore dhe parashikohet të fillojë zyrtarisht në fillim të vitit 2017.

### 10.2 Bashkëpunimi rajonal

Gjatë vitit 2016, Departamenti i Zhvillimit Rajonal duke e vlerësuar bashkëpunimin rajonal esencial për një zhvillim të qëndrueshëm, ka vijuar një proces gjithëpërfshirës konsultimesh me aktorët, kryesisht lokalë, në zonat ndërkufitare, një proces që është shtrirë pothuaj gjatë gjithë kufirit Shqipëri - Mali i Zi dhe Shqipëri -Kosovë. Ky proces i nxitur nga komuniteti lokal i këtyre zonave dhe përfaqësues të qeverisjes vendore në Shqipëri dhe atyre në vendet fqinjë është mbështetur nga Departamenti i Zhvillimit Rajonal duke u fokusuar fillimisht në kryerjen e një analize të situatës social - ekonomike në këto zona, në infrastrukturën lidhëse mes komuniteteve në kufi, traditën e komunikimit mes tyre, situatën me shërbimet bazë si dhe mundësitë që ofron kjo zonë si nga pikëpamja turistike edhe nga mundësitë ekonomike, zhvillimi i biznesit etj. Në kuader të këtij partneriteti 2 aplikime u dorëzuan në kuadër të thirrjes për projekte të IPA CBC Shqipëri Mali i Zi, me partner Komunën e Ulqinit dhe Rrozhajës në Malin e zi.

Iniciativa e FSHZH për bashkëpunimin me Kosovën, materializuar me ngritjen e zyrës rajonale të FSHZH në Gjakovë, vijoi me ngritjen e Bordit të Përbashkët për zhvillimin e zonës ndërkufitare Shqipëri Kosovë, me përfaqësues të pushtetit vendor në këtë zonë, të përfaqësive diplomatike dhe FSHZH. Gjithashtu, u mobilizua Asistenca Teknike, bashkëfinancuar nga Ambasada e Mbreterisë së Norvegjisë, e cila realizoi studimin e zonës pilot Tropojë Has Gjakovë, dhe elaborimin e masave për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm në këtë zonë duke finalizuar edhe projekt fisha strategjike të përbashkëta për t'u aplikuar në programet e BE apo donator të tjerë. Ky proces ka çuar në krijimin e një partneriteti të fortë mes FSHZH dhe pushtetit lokal në Kosovë, partneriteti i cili do të konsolidohet në periudhën në vijim me aplikimin e përbashkët për financim të këtyre projekteve nga donatorë potencial.

Gjithashtu, DZHR ka vijuar punën në funksion të konsolidimit të partneritetit me Greqinë me qëllim krijimin e një partneriteti të fortë dhe të qëndrueshëm në kuadër të thirrjeve për projekte të ardhme CBC apo dhe të tjera të BE-së. Gjatë kësaj periudhe u hap Thirrja e 2-të e Programit Greqi Shqipëri, ku FSHZH aplikoi në disa partneritete në fushën e turizmit dhe trashëgimisë kulturore.